



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
"Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile: "Mësues për arsimin e mesëm të
lartë" dhe "Mësues për arsimin e mesëm të ulët"
Kolegji Universitar "Bedër"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Alda Jashari (Cicko)


Dr. Valbona Softa (Loshi)


Korrik / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Master Profesional në: Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile: "Mësues për arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për arsimin e mesëm të ulët"

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "BEDËR"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze
3	Emërtimi i programit të studimit:	MP në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile "Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë" dhe "Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr.373, datë 25.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 - 9 / PAE; / 0 PAK 2022-2023 - 7 / PAE; / 0 PAK
18	Numri i studentëve:	<u>Profili: Mësues për AMU</u> 2021-2022 4 studentë; 2022-2023 2 studentë;




2



		Profili: Mësues për AML 2021-2022 9 studentë; 2022-2023 16 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesionl në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët” është program i ciklit të dytë të studimeve, i cili ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Kolegji Universitar “BEDËR”. Kolegji Universitar “BEDËR” është institucion privat i arsimit të lartë, i cili zhvillon veprimtarinë në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët” licensuar fillimisht me Urdhër të MAS, Nr. 10, datë 16.01.2012, i emërtuar program i ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm” me 90 kredite dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike. Programi aktual Master në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët” është riorganizuar me urdhër të MAS Nr.373, datë 25.09.2021 me një kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh akademike dhe 120 kredite. Organizimi, ndarja dhe strukturimi i programit të studimit mbështetet plotësisht në legjislacionin në fuqi, përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr.80/2015 dhe specifikat e përcaktuara në VKM nr.41/2018 "Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL" dhe Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve. Programi i studimit Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Kolegjit Universitar BEDËR duke synuar ti pajisë studentët me formimin e duhur shkencor dhe aftësitë e duhura praktike dhe profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Kreditet e siguruara përgjatë këtij cikli janë 120, të shpërndarë përkatësisht me 60 kredite për vit. Programi i studimit synon të



3


përbushë objektivat formues përmes lëndëve dhe moduleve të cilat u japin studentëve një formim të plotë profesional në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze duke iu ofruar një gamë të gjerë njohurish në pedagogji, psikologji, metodologji, teknika dhe strategji të mësimdhënies së gjuhës së huaj, didaktikë etj. Studentëve u krijohet gjithashtu mundësia që në nivel praktik përmes praktikave profesionale dhe përvojës së fituar në terren të zhvillojnë edhe më tepër disa prej aftësive të fituara.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Kolegji Universitar "BEDËR", në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit, 2017" ka aplikuar më datë 01.06.2022 në Agjensinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për nisjen e procedurave për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile "Mësues për Arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për Arsimin e mesëm të ulët". Ky është procesi i parë i vlerësimit të standarteve të cilësisë për këtë program studimi.

Në përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), të ngritur nga ASCAL për procesin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master Profesional në "Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile "Mësues për Arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për Arsimin e mesëm të ulët" u përzgjedhën dy ekspertë: Dr. Valbona Loshi (Softa), pedagoge në Kolegjin Universitar "Ëisdrom" dhe Dr. Alda Jashari (Cicko), pedagoge në Universitetin "Fan S. Noli".

GVJ u kontaktua në muajin Janar 2023 nga përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli dhe zhvilloi takime në ambjentet e ASCAL, ku u njoh me procedurën e vlerësimit, shqyrtimin e Dosjes së Vetëvlerësimit, kryerjen e vizitës në institucion dhe hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe njëkohësisht ekspertëve i'u dorëzua materiali i plotë i depozituar për vlerësimin e jashtëm. Sipas procedurës së shërbimit AMS dhe në zbatim të Rregullores të ASCAL për procesin e shqyrtimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit shoqërues të tij, u përpilua agjenda e vizitës në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Kolegji Universitar "BEDËR" në datat 4-5 Prill, 2023. Grupit të Vlerësimit të jashtëm, gjatë vizitës në institucion, i'u vu në dispozicion një sallë, ku u zhvilluan të gjitha takimet e parashikuara sipas agjendës. Në këto takime ishte e pranishme specialistja e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli. Në përfundim të këtij procesi, GVJ vizitoi ambjentet mësimore dhe didaktike të institucionit dhe kërkoi dokumentacion shtesë për diskutimet e ngritura gjatë vizitës, i cili u dorëzua në ASCAL më datë 11.04.2023. GVJ, pasi rishikoi dokumentacionin e plotë të paraqitur në ASCAL dhe në reflektim të takimeve që pati në institucion, paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas fushave, standarteve dhe kriterëve përkatëse, për programin e studimit.

4

Kolegji Universitar "Bedër" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.06.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 81/20 Prot, datë 27.06.2023. Kolegji Universitar "Bedër" përcjell në ASCAL më datë 05.07.2023, me anë të shkresës me Nr. 110/2 Prot., datë 04.07.2023, "Komente në lidhje me draft raportin".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Për Komentin që i përket standardit Standartit III.4:



GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, por i qëndron konstatimit se në kategorinë (D) të veprimtarive formuese në planin mësimor të programit të studimit, përveç praktikës profesionale, e cila merr kreditet maksimale (10 %), nuk ka lëndë të tjera plotësuese, (informatikë, gjuhë të huaja), si edhe është parashikuar në VKM nr. 41, datë 24.1.2018. Përsa i përket komentit të institucionit se: "lidhur me mospërputhjen në dokumentacion po punohet për përditësimin e tyre", GVJ sqaron se në konsideratë meret vetëm dokumentacioni i paraqitur për shqyrtim përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm. **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

2. Për Komentin që i përket standardit IV 1, kriteri 1:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit, në lidhje me kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në programin e ciklit të dytë, por i qëndron formulimit në tekst se në këtë program studimi është angazhuar në mësimdhënie personel akademik me kualifikimin "Master i Shkencave", të cilin e mbështet në nenin 59 të LAL 80/2015, pika 6 ku theksohet se " personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të ketë së paku kualifikimin pasardhës"; në nenin 59 pika 3 të po këtij ligji në të cilin përcaktohet se "Në kategorinë Profesor përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë Profesor dhe Profesor i Asociuar" dhe në VKM nr 41, datë 24.01.2018, pika 1, gërma II ku thuhet se "Titullari i lëndës është personel akademik i kategorisë Profesor i cili harton programin e lëndës në përputhje me planin mësimor të programit të studimit". **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

3. Për Komentin që i përket standardit IV.3 kriteri 2:

GVJ shqyrtoi dhe vlerëson sqarimin e institucionit lidhur me përditësimin e literaturës dhe pasurimin e bibliotekës fizike me fondin e librave të rekomanduar në literaturën e detyrueshme të lëndëve të ofruara, por i qëndron formulimit në tekst duke theksuar se konstatimi i bërë në RVJ





bazohet në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, Shtojca nr 4 “Standardet Për Sigurimin e Cilësisë Për programet e Ciklit të Dytë Master Profesional” dhe më konkretisht te Standardi II.4 , kriteri 5 në të cilin përcaktohet se “Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit” dhe në Standardin IV.3, kriteri 4 të po këtij kodi ku thuhet se “Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës dhe specifikës së programit të studimit” **Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar Raportit të Brendshëm të Vlerësimit (RVB), si edhe duke u mbështetur në dokumentacionin shoqëruar në Dosjen e Vetë vlerësimit, (DVV), Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Kolegji Universitar “BEDËR”, referuar në këtë Raport Vlerësimi me shkurtimin KU “BEDËR”, është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011 me emërtimin Shkolla e Lartë Private “Hëna e Plotë”, (Bedër) dhe është riorganizuar me Urdhër të MASR Nr. 200, datë 3.07.2020 në dy njësi kryesore: Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, të cilët filluan veprimtarinë e tyre në vitin akademik 2020-2021 (Evidenca nr. 15 Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për liçencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” Bedër; Evidenca nr.1 - Dokumentacioni shtesë Vendimi i MAS për riorganizimin e fundit te institucionit). GVJ konstaton se programi aktual i studimit Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e mesëm



6


	<p>të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” është riorganizuar me Urdhër të MASR Nr. 373, datë 23.09.2021, me një kohëzgjatje për dy vite akademike dhe ofrohet me 120 kredite, (ECTS) (Evidenca nr. 22 Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional”). GVJ konstaton se Programet e studimit që Kolegji Universitar “Bedër” ofron në fushën e shkencave humane, teknologjisë dhe biznesit janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor (Ref.Ligji Nr.80/2015), nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Bedër, 2018-2023).</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë së tij, që reflektohet në Statutin dhe Rregulloren themelore të KU “Bedër”. (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”). Gjithashtu, GVJ konstaton se program i studimit ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Drejtësisë dhe aktualisht ndodhet në vitin e dytë të veprimtarisë së tij. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se programi synon të përgatisë mësues të gjuhës angleze të një niveli të lartë, si rezultat i kurrikulave bashkëkohore për kurset e pedagogjisë, zhvillimit njerëzor dhe metodologjinë angleze (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregulloreve të Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në DVV, rezulton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Strategjinë dhe Rregulloren themelore të KU “Bedër”, të cilat parashikojnë ofrimin e një arsimi cilësor dhe aftësimin e studentëve të diplomuar për tu pranuar me lehtësi nga tregu i punës. (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”).</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar në mbështetje të strategjisë kombëtare për arsimin e lartë në vend, duke parashikuar zbatimin e përpiktë të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.80/2015. GVJ evidenton se misioni për respektimin e interesave kombëtare dhe prirjet globale të zhvillimit janë në thelb të këtij programi studimi, duke qenë se ky program studimi ofrohet në kushte kur nevoja për përgatitjen e mësuesve në gjuhën angleze për arsimin mesëm të ulët dhe të lartë në vend është një domosdoshmëri dhe ndërkombëtarizimi i programit të studimit reflektohet me njohjen e krediteve të tij në institucione ndërkombëtare homologe, si edhe për faktin e ofrimit të tij në gjuhën angleze (Evidenca nr. 22 Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional”; Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”). GVJ konstaton se KU “Bedër” është certifikuar nga Bordi i Akreditimit për akreditimin institucional për pesë (5) vite me Vendim Nr. 57, datë 16.02.2021 dhe demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e programit të studimit (Evidenca nr. 45 Vendimi i Bordit të Akreditimit, nr.57, date 16.12.2021 Për akreditimin periodik të IAL KU “Bedër”).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është hartuar në mbështetje të strategjisë kombëtare për arsimin e lartë në vend, duke parashikuar zbatimin e përpiktë të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.80/2015. Misioni për respektimin e interesave kombëtare dhe prirjeve globale të zhvillimit janë në thelb të këtij program studimi, duke qenë se ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze dhe në kushte kur nevoja për përgatitjen e mësuesve në gjuhën angleze për arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë në vend është një domosdoshmëri dhe ndërkombëtarizimi i programit të studimit reflektohet me njohjen e krediteve të tij në institucione ndërkombëtare. KU “Bedër” e ushtron veprimtarinë e programeve të studimit që ofron në përputhje me dokumenta themeltarë si Statuti dhe Rregullorja e institucionit, Plani strategjik i tij, të cilët garantojnë se këto programe nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Drejtësisë në KU “BEDËR”, i cili ofron programin e studimit Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” ka një numër total (8) personel akademik efektiv, (PAE); dy (2) personel akademik me kontratë (PAK) dhe (1) personel ndihmës akademik. Profesorati i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023, përbëhet nga katër (4) Doktorë të Shkencave dhe (3) MSc. dhe një (1) Dr. në proces (PAE);</p> <p>Përsa i përket kualifikimeve të personelit akademik me kontratë, GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2021-2022 është deklaruar një (1) staf akademik (PAK) me gradën shkencore Doktor dhe një (1) MSc.; - viti akademik 2022-2023 është deklaruar një (1) staf akademik (PAK) me titullin Prof Asoc. dhe (1) Msc. <p>(Evidencë-Aneks RVB-Tabela Nr.1 dhe 2, Numri i personelit akademik për njësinë bazë).</p> <p>Në takimin në institucion u deklarua se programi i studimit mbulohet vetëm nga stafi PAE dhe kjo evidentohet nga të dhënat tabelore në DVV (Evidencë – Aneks RVB- Tabela 4- Ngarkesa totale e personelit akademik).</p> <p>GVJ konstaton se personeli akademik i këtij programi studimi ka angazhim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor (Evidenca nr. 16 CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit.).</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë (Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë).</p> <p>Programi i studimit ofrohet me 120 kredite, sipas sistemit (ECTS),</p>

<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>realizohet me kohë të plotë në dy (2) vite akademike dhe i përket nivelit (7) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). GVJ konstaton se kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit përmban veprimtaritë formuese të kategorive (A-E) sipas VKM 41, 2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruara nga IAL-të”, me lëndët përkatëse të cilat janë të kodifikuara dhe përmbajnë kreditet respektive të tyre. Referuar dokumentacionit shtesë në Dosjen e Vetëvlerësimit, GVJ vëren se institucioni KU “BEDËR” ka kryer procedurën e aplikimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore, (QSHA) për regjistrimin e formës së diplomës dhe Supplementit të saj, e miratuar me vendim Senati të KU “BEDËR”, Nr. 5, datë 02.03.2023. GVJ nuk konstaton dokumentacion referencë në DVV, përsa i përket kodit të programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët”, (Evidenca nr.2 - dokumentacioni shtesë - Model i Diplomës dhe Supplementit të Diplomës me vendim Senati; Evidenca nr.3 – dokumentacioni shtesë-Procedurë aplikimi në MAS për miratimin e Formës së Diplomës dhe Supplementit të saj).</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, i cili e ofron atë, përpos dy programeve të tjera të studimit: Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” dhe Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” (Evidenca nr. 10 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca nr. 4 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë; Evidencë-Aneks RVB, Tabela 3, Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse).</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” ofron programin “Master profesional”, në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët” brenda profilit të institucionit, pasi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si dhe nga njësia bazë, “Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze” (Evidenca nr. 10</p>

<p>institucionet partnere.</p>	<p>Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë). GVJ konstaton mungesën e publikimit të ofrimit të programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët” në rregulloren e fakultetit, Kreu IV, Neni 15 (Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. GVJ gjithashtu konstaton se “Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë”, Neni 4, “Struktura e programeve të Ciklit të dytë”, programi i studimit rezulton me emërtimin “Master Profesional në mësuesi, gjuhë angleze për arsimin e mesëm”, kohëzgjatja 1.5 vite (Evidenca nr. 4 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>KU “BEDËR” ofron trajnime profesionale të mëtjshme në formën e moduleve të tilla si: “Zhvillimi moshor i fëmijëve dhe të rinjve”, Menaxhimi i klasës dhe Konfliktëve” për palë të treta të interesuara si drejtorë të institucioneve arsimore, mësues, specialistë të DARZ/ të cilat realizohen nga personeli akademik i institucionit (Evidenca nr. 92 Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Eoei Hung, bashkë me linqet përkatëse). Në RVB citohet se trajnimet kryhen edhe për studentët e diplomuar, por GVJ nga referencat e përmenduar nuk konstaton se të tilla organizime kryhen në bashkërendim me punëdhënësit (Evidenca nr. 91 Marrëveshja e Bashkëpunimit me Universitetin e North Dakota; Evidenca nr. 92 Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Woei Hung, bashkë me linqet përkatëse; Evidenca nr. 90 Eëbminare nga “Educators ëithout Borders”). GVJ vëren domosdoshmërinë e përfshirjes së punëdhënësve në trajnime të mëtjshme profesionale të studentëve të diplomuar krahas trajnimeve me karakter akademik për të realizuar procesin e gjurmimit të diplomantëve në tregun e punës.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se KU “Bedër” demonstroi se ka përvojën e duhur institucionale në fushën e arsimit të lartë, për të ofruar programe studimi të ciklit të dytë, dhe më specifikisht në fushën e mësuesisë. GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Master Profesional” në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë” dhe njësisë bazë “Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze”, i cili ofron edhe dy programe të tjera studimi: Bachelor në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze” dhe Master i Shkencave në “Gjuhë dhe Letërsi Angleze”.</i></p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>KU “Bedër” ka hartuar dhe miratuar aktet e brendshme për mbarëvajtjen dhe funksionimin e njësive akademike dhe ndihmës - akademike. GVJ konstaton se procesi i ndarjes së detyrave është rregulluar me emërimin e koordinatorëve të posaçëm në detyra specifike të tilla si: koordinatori i programeve master; koordinatori i zhvillimit të kurrikulave dhe koordinatori i kërkimit shkencor. (Evidenca nr. 9 Organigrama e KU Bedër; Evidenca nr. 10 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë). GVJ konstaton se institucioni me qëllim ngritjen e marrëdhënieve të frytshme të bashkëpunimit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse, ka hartuar rregullore të posaçme për organizimin dhe funksionimin e institucionit, në disa nivele: në nivel institucional, në nivel njësie kryesore, në nivel njësive bazë dhe në nivel administrativ (Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi Organizimin Akademik; Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidenca nr. 11 Rregullore mbi Organizimin Administrativ)</p> <p>GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze nëpërmjet këshillit të tij cakton këshilltarin e tij të karrierës pranë Zyrës së Planifikimit të karrierës, si edhe këshilltarët akademikë për programet e studimit Master që departamenti ofron (Evidenca nr. 47 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcakimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera; Evidenca nr. 46 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë). GVJ konstaton se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze kryen analizën vjetore të punës me qëllim evidentimin e problematikave, arritjeve dhe dhënien e rekomandimeve (Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti</p>

<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Akademik 2021-2022).</p> <p>GVJ konstaton se në mbështetje të realizimit të objektivave të procesit mësimor dhe objektivave formues të studentëve, të parashikuar në rregulloren e programit të studimit, KU “BEDËR” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi si brenda dhe jashtë vendit, kryesisht me fokus shkëmbimin e personelit akademik dhe studentëve, zbatimin e projekteve në kuadër të projekteve Erasmuss + në Kroaci, Rumani, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”).</p> <p>Konkretisht, institucioni ka lidhur në total 57 marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vendit me institucione homologe të arsimit të lartë të llojit: “universitet”, “kolegj”, “institute”, por edhe me institucioneve publike si: Bashkia Elbasan, Bashkia Devoll, si dhe fondacione edukimi dhe qendra të gjuhëve të huaja si “British Council”. GVJ konstaton lidhur me partneritetin e bizneseve vendase ose të huaja se KU “BEDËR” ka përfshirë 27 institucione partnere me karakter të tillë si: studio ligjore, komuna, shoqata mediatike, shtëpi botuese, akademi të gjuhëve të huaja (Evidenca nr. 83 Lista e Institucioneve Partnere; Evidenca nr. 84 Lista me Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) dhe Mobiliteti për Staf dhe Studentë me Institucionet Homologe, brenda dhe ose jashtë Vendit)</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe referuar informacionit në RVB, GVJ konstaton se KU “BEDËR” ka lidhur tre (3) marrëveshje të posaçme me institucione dhe kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Akademia e Gjuhëve Evropiane; 2. Turgut Ozal Education; 3. Shkolla jopublike Arbëria; <p>(Evidenca nr. 89 Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institucione Jopublike të Arsimit Parauniversitar).</p> <p>GVJ konstaton se në tableën përmbledhëse për institucionet bashkëpunuese për praktikat profesionale, raportohen 8 të tilla (Aneks RVB –Tabela 5).</p> <p>GVJ përgjatë takimit në institucioni u informua se mundësia e kryerjes së praktikave mësimore ndëmjetësohet nëpërmjet zyrave</p>




	vendore arsimore, në rastet kur studentët nuk e zhvillojnë praktikën në institucionet me të cilat është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit më këtë focus (Evidenca nr.7 Procedure per praktikën profesionale).		
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ evidenton se në dokumentacionin shoqërues të RVB janë paraqitur raporte analitike për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit nga zyra e marrëdhënieve me jashtë, ku analizohet zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për mobilitetin e personelit akademik, dhe pse ky mobilitet është minimal, një (1) personel akademik për programin e studimit studimit “Master Profesional” në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët” në kuadër të programit Erasmus + në Rumani, por edhe për arsye se programi i studimit është në vitin e dytë aktiv të veprimtarisë së tij (Evidenca nr. 84 Lista me Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) dhe Mobiliteti për Staf dhe Studentë me Institucionet Homologe, brenda dhe ose jashtë Vëndit), Evidenca nr. 97 Rast Shkëmbimi i Stafit Akademik).		
Konkluzione	<i>KU “Bedër” ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, si brenda dhe jashtë vëndit, kryesisht me fokus organizimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, realizimin e praktikës profesionale dhe shkëmbimin e personelit akademik dhe studentëve, zbatimin e projekteve në kuadër të programeve Erasmuss +. Konkretisht, institucioni ka lidhur në total 57 marrëveshje bashkëpunimi brenda dhe jashtë vëndit me institucione homologe të arsimit të lartë dhe 27 institucione partnere me karakter të tilla si: studio ligjore, komuna, shoqata mediatike, shtëpi botuese, akademi të gjuhëve të huaja.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

14

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Struktura organizative e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët ofruar nga Kolegji Universitar “BEDËR” mbështetet në bazën ligjore të përcaktuar në LAL, nr 80/2015, VKM nr. 421, datë 24.01.2018 dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve duke siguruar vlerësimin e lëndëve dhe moduleve me kredite (ECTS). (Evidenca nr. 32 LAL nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; Evidenca nr. 33 Udhëzimi nr. 15/2008 Për Organizimin e Studimeve në IAL)</p> <p>Cikli i dytë i studimeve Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët është një program me kohë të plotë dhe shtrihet përgjatë dy viteve akademike. Në përfundim të ciklit, studentët sigurojnë 60 kredite (ECTS) për secilin vit, 120 në total.</p> <p>Hartimi i këtij programi është mbështetur në rregullat, procedurat dhe detyrat e përcaktuara në statutin dhe rregulloren themelore të Kolegjit Universitar “BEDËR”, rregulloren e programit të studimit dhe është miratuar me vendim të Senatit të KU “BEDËR” (Evidenca nr. 5 Rregullorja themelore e KU “BEDËR” Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master)</p> <p>Pas shqyrtimit të materialit plotësues të përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij programi studimi përcaktohen ndarjet e lëndëve në semestra, numri i krediteve për secilën lëndë dhe numri i orëve të zhvilluara brenda dhe jashtë auditorit. (Evidenca Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose</p>	<p>Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”, pjesë e dokumentacionit të bashkangjitur në dosjen e vlerësimit të brendshëm dhe pas takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ konstatoi se ky program studimi synon të</p>

punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

përbushë objektivat formues përmes lëndëve dhe moduleve të cilat u japin studentëve një formim të plotë profesional në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze. Ky program studimi ofron një gamë të gjerë njohurish në pedagogji, psikologji, metodologji, didaktikë teknika dhe strategji të mësimdhënies së gjuhës së huaj etj. Studentëve u krijohet gjithashtu mundësia që në nivel praktik përmes praktikave profesionale dhe përvojës së fituar në terren të zhvillojnë edhe më tepër disa prej aftësive të fituara. **(Evidenca Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10; Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional)**

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, konstatoi disa mospërputhje midis strukturës së planit mësimor hartuar sipas veprimtarive formuese të përfshirë në rregulloren e programit të studimit dhe dokumentacionit të paraqitur në shtojcën e RVB. **[Evidencë nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master; Aneks RVB Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion, bazuar tek burimet dhe referencat e përditësuara, GVJ konstaton se ndarja e veprimtarive në kategori formuese është parashikuar si më poshtë;



Kategoria	Tipi	IAL	Standardi
A	Lëndë Bazë	10 %	5 – 10 %
B	Lëndë karakterizuese	40 %	30– 40 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	25 %	20 – 30 %
D	Lëndë plotësuese	10 %	10 %
E	Detyrime përmbyllëse	15 %	10 – 20 %

(Evidenca nr.4 Dokumentacioni shtesë-Vendim MAS për miratimin e planit mësimor të programit të studimit sipas veprimtarive formuese; Aneks RVB Tabela 9)

GVJ rekomandon se ndarja e veprimtarive në kategori formuese, e hartuar në përbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara me


	<i>VKM, duhet të reflektohet edhe në rregulloren e programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	GVJ konstaton se programi i studimit Master në Mësuesi Gjuhë Angleze, është një program i ciklit të dytë të studimeve dhe në objektivat e përcaktuara qartë, synon formimin shkencor dhe aftësimin profesional të mësuesve të Gjuhës Angleze, sipas profilizimit për Arsimin e Mesëm të Ulët dhe Arsimin e Mesëm të Lartë.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Pas shqyrtimit të planit mësimor të programit të studimit Master Profesional në Mësuesi për të dy profilet, GVJ konstaton se cikli i dytë i studimeve shtrihet në dy vite akademike, përkatësisht 4 semestra dhe siguron 120 kredite në total duke përmbushur në këtë mënyë detyrimet ligjore. Lëndët e formimit psiko-pedagogjik zënë 25% të krediteve totale. Kurrikula e programit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” është hartuar në përputhje me detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 83 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në të cilin përcaktohet se të gjitha programet Master në fushën e mësuesisë të ofruara nga IAL-të në RSH duhet të kenë kurrikul të ngjashme deri në masën 80%. (Evidenca Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10; LAL 80/2015)
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se forma e organizimit, kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit, plani mësimor, programet lëndore (syllabuset), procedurat e rekrutimit të studentëve, forma e studimit, kriteret e pranimit, njohja e krediteve të fituara më parë dhe transferimet e studentëve janë përcaktuar në rregulloren e programit të studimit të miratuar nga Senati i KU “BEDËR” (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional ;Evidenca nr. 5 Rregullore themelore e Kolegjit Universitar BEDËR; Evidencë Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10)

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin plotësues të vënë në dispozicion nga GVB dhe konstatoi se plani mësimor i zbatuar për programin e studimit është hartuar në përputhje me përcaktimet e bëra në LAL 80/2015 dhe siguron përputhjen në emërtesë dhe përmbajtje në masën e parashikuar në ligj duke mundësuar njohjen dhe transferimin e studimeve nga ky institucion drejt IAL-ve të tjera. (Evidenca Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10)</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, programi i studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile “Mësues në AML” dhe “Mësues në AMU” është kodifikuar në përputhje me VKM numër 310/2022 dhe mban kodin 72 MP 0114 A. GVJ nuk konstaton dokumentacion referencë për këtë të dhënë.</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura e programit të studimit mbështetet në bazën ligjore të përcaktuar në LAL dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi i studimit përmbush objektivat formues dhe i pajis studentët me aftësi dhe kompetenca në fusha dhe disiplina specifike. Praktika profesionale dhe detyrimet përmblylëse janë të reflektuara me kredite. Programi i studimit siguron formimin shkencor dhe aftësimin profesional të mësuesve të Gjuhës Angleze për Arsimin e Mesëm të Ulët dhe Arsimin e Mesëm të Lartë. Programi i studimit është i organizuar me 120 kredite nga të cilët 25 për qind sigurojnë formimin e përgjithshëm psiko-pedagogjik. 80 për qind e kurrikulës është në përputhje me programet e ngjashme në fushën e mësuesisë. Plani mësimor i zbatuar është hartuar në përputhje me bazën ligjore dhe siguron përputhjen në emërtesë dhe përmbajtje në masën e parashikuar në ligj. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në këtë institucion është realizuar në</i></p>

	<i>përputhje me përcaktimet në kuadrin ligjor të MAS. Programi i studimit është kodifikuar në përputhje me VKM.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Kolegji Universitar “Bedër”, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 57, datë 16. 02. 2021 që e akrediton institucionin për 5 vite akademike.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë si njësi kryesore është i organizuar në 4 njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Drejtësisë; 2. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze; 3. Departamenti i Shkencave Islame; 4. Departamenti i Shkencave të Komunikimit; <p>Programi i studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët” ofrohet nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, si njësi bazë e cila është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. GVJ konstaton se funksionimi dhe organizimi i njësive kryesore dhe njësive bazë të tij kryhet në përputhje me detyrimet ligjore dhe aktet nënligjore të përcaktuara në LAL 80/2015, udhëzimit 27/2016 të MAS sikundër dhe me statutin dhe rregulloren e KU “BEDËR”</p> <p>Referuar dokumentacionit të përcjell, GVJ konstaton se programet e ofruara nga ky institucion i arsimit të lartë janë disa të akredituara dhe të tjera në proces akreditimi. Organigrama e njësië kryesore, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe GVB-të e ngritura me qëllim vlerësimin e cilësisë funksionojnë në përputhje me parashikimet dhe kuadrin rregullator të përcaktuar në statutin e IAL-së,</p>


	<p>rregulloren themelore të KU BEDËR dhe rregulloren e njësisë kryesore. (Evidenca nr. 48 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca nr. 5 Rregullorja themelore e KU BEDËR” ; Evidenca nr. 2 Statuti i KU “BEDËR”; Evidenca nr. 52 Vendim për r ngritjen e grupit të vlerë simit të brendshëm)</p> <p>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë paraqitje:</p> <table border="1" data-bbox="539 600 1364 1055"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>4</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>8</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table>	Kualifikimi i stafit	Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze		PAE	PAK	Prof.Dr	-	1	Prof.Asoc	-	-	Dr/PhD	4	-	Msc	4	1	Gjithsej	8	2
Kualifikimi i stafit	Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze																				
	PAE	PAK																			
Prof.Dr	-	1																			
Prof.Asoc	-	-																			
Dr/PhD	4	-																			
Msc	4	1																			
Gjithsej	8	2																			
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Pasi shqyrtoi GVJ konstaton se njësi bazë, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, në fillim të vitit akademik angazhon një personel nga Zyra e Planifikimit të Karrierës i cili është përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale. Detyra e tij është që së bashku me pedagogun që zhvillon këtë lëndë të informojë studentët për procedurat dhe mundësinë për përzgjedhjen e institucioneve pranë të cilave do të zhvillohet kjo praktikë. Kjo strukturë është gjithashtu përgjegjëse për mbikqyrjen e gjithë procesit dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës. Hapat proceduriale që duhen ndjekur për zhvillimin e praktikës profesionale u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit të dytë akademik.</p>																				
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit</p>	<p>Bazuar te materiali i përcjellë përmes DVV dhe vizitave të kryera pranë institucionit, GVJ konstaton se në mbështetje të mirëfunksionimit të veprimtarisë mësimore, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ka caktuar një koordinor të veçantë të programit të studimit, të zgjedhur nga Komiteti Shkencor i kësaj njësie.</p> <p>Detyrat e koordinorit të programit të studimit janë të përcaktuara në nenin 10 të rregullores së studimeve dhe</p>																				

dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	provimeve të ciklit të dytë në të cilën parashikohet se koordinatori i programit të studimit i propozon këshillit të departamentit planifikimet e personelit akademik, raporton për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe në bashkëpunim me udhëheqësin e kërkimit shkencor ndjek mbarëvajtjen e punës kërkimore të studentëve (Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë ; Evidenca nr. 48 Vendimi për caktimin e koordinatorit të programeve master për vitin akademik 2022-2023)		
Konkluzione	<i>Funksionimi dhe organizimi i njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit kryhet në përputhje me detyrimet ligjore dhe aktet nënligjore të përcaktuara në LAL, statutin dhe rregulloren e KU "BEDËR. Personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale është personel administrativ i Zyrës së Këshillimit të Karrierës. Zyra e Këshillimit të Karrierës është përgjegjëse për mbikqyrjen e gjithë procesit, mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës. Njësia bazë ka caktuar në rolin e koordinatorit të programit me vendim të Këshillit Shkencor një anëtar të stafit akademik, detyra e të cilit është mbikqyrja e mbarëvajtjes së programit të studimit dhe punës kërkimore të studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV, përcjellë për GVJ, rezulton se njësia përgjegjëse për programin e studimit Master në Mësuesi "Gjuhë Angleze" me profile" Mësues për arsimin e mesëm të ulët" dhe "Mësues për arsimin e mesëm të lartë", Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, ka siguruar dhe disponon informacionin e nevojshëm në lidhje me rregulloren themelore të institucionit, rregulloren e njësisë kryesore, rregulloren e programit, rregulloren e sekretarisë mësimore, planin mësimor, sikurse dhe ka të mirëpërcaktuara të dhënat bazë mbi objektivat e programit të studimit, përshkrimin e programit,

	<p>elementët përbërës të tij, programet lëndore, strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat mbështetëse, kriteret e pranimit të studentëve, procedurat e rekrutimit, format dhe mënyrat e vlerësimit, të dhënat mbi stafin akademik, dhe nivelin e tyre të kualifikimit, mjediset dhe infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional ; Evidencë Aneks RVB Plani Mësimor, Tabela 10)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Mbështetur tek të dhënat e përcjella përmes DVV, konstatohet se plani mësimor dhe rregullorja e programit të studimit strukturon dhe detajon organizimin e programit mësimor në lëndë, module, aktivitete formuese dhe praktike në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi. Referuar planit mësimor të këtij programi studimi, vërehet se përgjatë dy viteve akademike janë parashikuar të zhvillohen 17 lëndë sikurse dhe praktika profesionale dhe mbrojtja e temës së diplomës. 120 kreditet e siguruara në përmbyllje të studimeve pranë këtij programi janë shpërndarë në 4 semestra. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ konstaton se kushtet dhe kriteret e pranimit të studentëve, të transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në nenin 12 të rregullores së programit të studimit, në rregulloren e transferimit të studimeve dhe nenin 24 të rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët; Evidenca nr. 25 Rregullorja e transferimit të studimeve; Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin e përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët përcaktohet organizimi i lëndëve në semestra (4 semestra me nga 30 kredite secili) sikurse dhe ngarkesa mësimore në auditor e cila përlllogaritet për tri semestrat e parë me 280 orë në auditor dhe semestrin e fundit me 45, në total 885. Orët e përgatitjes së studentit jashtë auditorit (të cilësuara si “punë individuale” në</p>

<p>jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>planin mësimor për Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët dhe “tjetër” për planin mësimor të profilit Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë) përlllogariten me 450 orë për çdo semestër, 1800 orë në total. (Evidenca Aneks RVB, Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10; Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile me profile Mësues për Asimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët)</p> <p>Referuar të dhënave statistikore të marra përmes DVV rezulton se ngarkesa totale në auditor për studentët e programit është 525 orë leksione, dhe 360 seminare. GVJ konstaton se për këtë program studimi nuk janë parashikuar orë laboratorike. (Evidenca Aneks RVB Tabela 13)</p> <p>Programet lëndore (syllabus-et) përfshijnë në përmbajtjen e tyre elementë specifikë të lidhur me numrin e leksioneve/seminareve, detyrave të kursit, projekteve, eseve dhe provimeve. Në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së lëndës përcaktohen edhe rregullat e frekuentimit, sistemi dhe mënyra e vlerësimit sikurse dhe forma e provimit. (Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit)</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>GVJ konstaton se për shkak të ristrukturimit të programit të studimit në vitin akademik 2021-2022, përmbajtja e këtij programi dhe programet lëndore nuk kanë patur nevojë për përditësim.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, përgjegjëse për programin e studimit disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Plani mësimor përcakton organizimin e lëndëve në semestra dhe ngarkesën mësimore sipas ndarjeve leksion-seminar dhe ngarkesën e parashikuar në auditor dhe atë si punë individuale nga studentët. Kushtet dhe kriteret e pranimit të studentëve, të transferimit dhe të ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në rregulloret e programit të studimit. Programet lëndore të përfshirë në planin mësimor përmbajnë elementë specifikë të lidhur me numrin e leksioneve/seminareve, detyrave të kursit, projekteve, eseve dhe provimeve. Në varësi të natyrës dhe përmbajtjes së lëndës përcaktohen edhe rregullat e frekuentimit,</i></p>

	<i>sistemi dhe mënyra e vlerësimit sikurse dhe forma e provimit. Për shkak të ristrukturimit të programit të studimit në vitin akademik 2021-2022, përmbajtja e këtij programi dhe programet lëndore nuk kanë patur nevojë për përditësim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Referuar informacionit të përcjellë përmes DVV, rezultoni se përmbajtja e veprimtarive mësimore të ofruara nga programi i studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët i siguron studentëve dije të thelluara dhe mundësi për formim dhe aftësim të mëtejshëm profesional. Pas shqyrtimit të planit mësimor të këtij programi, GVJ konstaton se raporti i ngarkesës mësimore midis teorisë dhe praktikës synon tu krijojë studentëve mundësi për përfshirjen sa më të plotë në tregun e punës. Gjatë takimeve të zhvilluara me personelin akademik dhe përfaqësues të studentëve u theksua edhe një herë se përmes detyrave të kursit, projekteve dhe veprimtarive praktike të zhvilluar në lëndë të caktuara sikurse dhe pjesëmarrjes dhe vëzhgimeve në orë të veçanta mësimore, studentët aftësohen në nivel praktik dhe aplikativ. (Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore gjatë gjithë ciklit të dytë të studimeve synon përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe mundëson pajisjen e studentëve me kompetencat dhe shprehjet bazë. Raporti teori-praktikë shpeshherë reflektohet me një numër të shtuar të orëve të seminarit, zgjedhje e diktuar nga natyra e programit të studimit dhe lëndëve të caktuara apo nevoja për zhvillimin e veprimtarive praktike gjatë procesit të mësimdhënies. Në kuadër të përmbushjes së këtyre objektivave dhe në plotësim të detyrimeve të përcaktuara në bazën ligjore praktika profesionale e përfshirë në kurrikul është përllogaritur me 12 kredite. Zhvillimi i

	<p>praktikës profesionale realizohet përmes marrëveshjes së bashkëpunimit të KU “BEDËR” dhe disa institucioneve të arsimit parauniversitar dhe organizatave të ndryshme. Nga evidencat e paraqitura si dokumentacion shtesë në RVB, në kuadrin e zhvillimit të praktikës profesionale institucioni ka siguruar marrëveshje me Turgut Ozal, Projekti Aftësi për Punën, Praktika.al etj.</p> <p>Gjatë takimeve në institucion, drejtues të njësisë bazë dhe anëtarë të stafit akademik saktësuan se për nevoja specifike institucioni ka krijuar kontakte bashkëpunimi me institucione të tjera, të cilat nuk janë përmendur në dokumentacionin e paraqitur. Studentët konfirmuan gjatë takimit se disa prej tyre po e zhvilloni praktikën profesionale pranë institucioneve publike të arsimit parauniversitar. (Evidencë Aneks RVB Plani mësimor; Aneks RVB ,Tabela 5 Institucionet dhe organizata bashkëpunuese; Evidencë nr. 89 Marrëveshje bashkëpunimi me institucione jopublike të arsimit parauniversitar)</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Pas verifikimit të strukturës së programit dhe përmbajtjes së programeve lëndorë, GVJ konstatoi se vlerësimi në këtë program studimi kryhet në përputhje me sistemin europian të transferimit të krediteve(ECTS) dhe se lëndët e ofruara sigurojnë rezultate të të nxënimit në përputhje me dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për aftësi, njohuri dhe kompetenca. Struktura e programit Master përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare. (Evidencë Aneks RVB, Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10; Evidencë nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile me profile Mësues për Asimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët)</p> <p>Gjatë takimit të zhvilluar me pedagogë dhe drejtues të njësisë bazë dhe asaj kryesore u theksua fakti se institucioni kishte krijuar një rrjet të gjërë bashkëpunimi dhe partneriteti me 54 universitete kombëtare dhe ndërkombëtare, organizata, shoqata dhe organizma të tjerë. (Evidenca nr. 83 Lista e institucioneve partnere)</p> <p>Megjithë numrin e lartë të marrëveshjeve të bashkëpunimit institucional, GVJ konstatoi se në kuadër të projekteve ndërkombëtare të shkëmbimit vetëm një anëtar i stafit akademik të departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze kishte përfituar një bursë nga program Erasmus + në Rumani. Ndërkohë që referuar dokumentacionit mbështetës, asnjë student i programit të studimit</p>

	<p>nuk është fitues në ndonjë program të ndërsjelltë bashkëpunimi. (Evidencë nr 85 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mobiliteteve për staf dhe studentë)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Dokumentacioni shtesë i shqyrtuar pas kërkesës së GVJ për saktësim të të dhënave përcakton se shpërndarja e lëndëve brenda kurrikulës synon arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ndarja e këtyre veprimtarive parashikohet në shtojcën nr. 2 të VKM nr. 41, datë 24.01.2018, ku përcaktohet qartë se përqindjen më të madhe duhet ta zenë lëndët karakterizuese. Përqindja e krediteve që përcaktojnë ngarkesën e lëndëve është shprehur si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A, Lëndë bazë: 10 % - Kategoria B, Lëndët karakterizuese: 40% - Kategoria C, Lëndët ndërdisiplinore: 25% - Kategoria D, Lëndët plotësuese: 10 % - Kategoria E, Detyrimet përmbyllëse; 15 % <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë përmes DVV, GVJ konstatoi se megjithëse ndarja e lëndëve sipas kategorive të paraqitur në planin mësimor është konform VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në rregulloren e këtij programi studimit, praktika profesionale është përlllogaritur me 12 ETCS, 10% të krediteve totale. Kjo ndarje është reflektuar edhe në planin mësimor.</p> <p>GVJ konstaton se nën kategorinë D të lëndëve plotësuese, në të cilën sipas përcaktimeve të shprehura në VKM 41/2018 duhet të përfshijë; gjuhë të huaja, njohuri kompjuterike dhe praktika profesionale vërehet se nga të tre komponentët e parashikuar, është plotësuar vetëm ai i praktikës profesionale.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse të studentit kryen në përputhje me përcaktimet e parashtruara në VKM dhe në rregulloren e programit të studimit dhe realizohen përmes mbrojtjes së punimit të punimit të diplomës e cila përlllogariten me 18 ETCS. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”; Evidenca nr 4. Dokumentacioni shtesë</p>

	Vendim MAS për miratimin e planit mësimor të programit mësimor të studimit të ndarë sipas veprimtarive formuese)
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit plotësues të dhënë në DVV dhe vizitave të kryera në institucion me personelin akademik, u konstatua se variantet e rishikuara dhe të dhe përditësuara të programeve lëndore ngarkohen në sistemin elektronik të Kolegjit Universitar Beder. (BIS). Gjatë takimit të zhvilluar me stafin akademik dhe drejtues të njësisë bazë u theksua fakti se para fillimit të vitit akademik, pranë këtij departamenti organizohen ëorkshops me qëllim analizimin e programeve lëndore dhe shkëmbimin e përvojës së stafit. Vëmendje të veçantë i kushtohet përzgjedhjes së metodave më të përparura të mësimdhënies, përditësimit të literaturës dhe përshtatjes së përmbajtjes së syllabuseve me politikën arsimore në vend dhe me kërkesat dhe nevojat gjithmonë e në rritje të studentëve. GVJ konstaton se struktura e hartimit të programit lëndor përfshin elementët e detyrueshëm të përcaktuar në shtojcën 2 të VKM nr. 41, datë 24.10.2018. (Evidencë Aneks RVB, Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10; Evidencë nr. 19 Syllabuset e lëndëve të programit)
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	GVJ gjykon se shpërndarja dhe përmbajtja e lëndëve synon përmbushjen e objektivave të parashikuara të programit të studimit "Master në Mësuesi "Gjuhë Angleze" me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët Në këtë cikël studimi, studentët pajisen me aftësi të veçanta të thelluara në nivel teorik dhe praktik në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Programi kombinon teorinë me praktikën duke nxitur tek studentët të menduarit krijues dhe kritik.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	DVV përmban informacion të detajuar lidhur me përmbajtjen e programeve të studimit. Dijet dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në ciklin e dytë u japin studentëve mundësinë për tu aftësuar dhe formësuar profesionalisht për tu përfshirë në tregun e punës. Duke qënë se programi Master profesional i ristrukturuar në vitin 2021-2022 nuk ka nxjerrë brezin e parë të të diplomuarve, në studimin e tregut të punës të zhvilluar nga departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angeze, nuk janë referuar të dhëna statistikore për nivelin apo llojin e punësimit. (Evidencë nr 24 Studimi tregu i zhvilluar nga Departamenti I Edukimi dhe Gjuhës Angleze)
Konkluzione	<i>Programi i studimit i siguron studentëve dije të thelluara dhe mundësi për formim dhe aftësim të mëtejshëm profesional. Raporti</i>

	<p><i>i ngarkesës mësimore midis teorisë dhe praktikës u jep mundësi për përfshirjen në tregun e punës. Shpërndarja e ngarkesës mësimore synon përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe mundëson pajisjen e studentëve me kompetencat dhe shprehitë bazë. Lëndët e ofruara sigurojnë rezultate të të nxënit në përputhje me dhe të krahasueshme me standardet ndërkombëtare për aftësi, njohuri dhe kompetenca. Struktura e programit përafrohet me programe të ngjashme ndërkombëtare. Shpërndarja e lëndëve brenda kurrikulës synon arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ndajja e këtyre veprimtarive u siguron studentëve mundësi për transferim studimesh, mobilitet apo punësim. Variantet e rishikuara dhe të përditësuara të programeve lëndore ngarkohen në sistemin elektronik. Përzgjedhja e metodave të mësimdhënies, përditësimi i literaturës dhe përmbajtja së syllabuseve bëhet në përshtatje me politikën arsimore në vend. Studentët pajisen me aftësi të veçanta të thelluara në nivel teorik dhe praktik në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Programi kombinon teorinë me praktikën duke nxitur tek ata të menduarit krijues dhe kritik. Dijet dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve në ciklin e dytë u japin studentëve mundësinë për t'u formësuar profesionalisht për t'u përfshirë në tregun e punës.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të	GVJ shqyrtoi dokumentacionin mbështetës të DVV dhe konstaton se përmbajtja e programit dhe përzgjedhja e lëndëve synon të jetë në përputhje me zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ-së ju vu në dispozicion një studim tregu i realizuar nga departamenti përgjegjës për programin e studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët. Studimi i tregut ishte kryer para çeljes së këtij programi studimi dhe në fokus kishte parashtrimin e një sërë mundësish për përzgjedhje profesionale që mund t’ju ofroheshin studentëve të diplomuar në

<p>diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>këtë program studimi Gjithashtu për hartimin e këtij studimi tregu ishin marrë parasysh edhe përvojat e krijuara nga programe e ngjashme të ofruara nga disa IAL publike të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Gjatë takimeve me personelin akademik të programit të studimit u ritheksua nevoja që përmbajtja e lëndëve të ofruara në këtë program të studimi të ishte në funksion të kërkesave dhe nevojave të tregut të punës. (Evidenca nr. 24 Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të bashkëpunimit mes institucionit dhe studentëve, GVJ konstaton se angazhimi i tyre kryhet kryesisht përmes pjesëmarrjes së rregullt dhe aktive në takimet e zhvilluara nga Këshilli i Departamentit.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ kreu me përfaqësues të studentëve ata ritheksuan faktin se të gjitha strukturat institucionale të KU “BEDËR” merrnin parasysh kërkesat dhe përmbushnin nevojat e tyre. Ata e ndienin veten të përfshirë në të gjitha nivelet e përfaqësimit. Për më tepër studentët japin mendime dhe shprehin vlerësimet e tyre përmes anketës “Vlerësimi i të diplomuarve për cilësinë e programit të studimit. (Evidenca nr. 55 Listë prezencë e këshillit të fakultetit për pjesëmarrjen e studentëve Evidenca nr. 30 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, Evidenca nr. 33 Anketë vlerësuese për lëndën dhe pedagogun)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përfshirë në DVV dhe vizitat e kryera në institucion me personelin akademik dhe grupin e studentëve, GVJ pohon se programi i studimit është i hartuar në bashkëpunim dhe në përputhje me programet e ngjashme të ofruara nga institucione të tjera publike dhe private si dhe nga një rrjet i gjerë profesionistësh të cilët i kanë përshtatur prioritetet e këtij programi me ato të ecurisë tërësore në të gjitha fushat e zhvillimit. (Evidenca Aneks RVB, Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10; Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përmbajtja e programit dhe përzgjedhja e lëndëve është në përputhje me zhvillimet në vend dhe kërkesat e tregut të punës. Studimi i tregut i kryer para çeljes së këtij programi studimi parashtron një sërë mundësish për përzgjedhje profesionesh që mund t’ju ofrohen studentëve të diplomuar. Për hartimin e këtij</i></p>

	<p><i>studimi tregu janë marrë parasysht edhe përvojat e krijuara nga programe e ngjashme të ofruara nga disa IAL publike të Republikës së Shqipërisë. Të gjitha strukturat institucionale të KU "BEDËR" vlerësojnë kërkesat e studentëve dhe përmbushnin nevojat e tyre. Studentët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e përfaqësimit dhe shprehin vlerësimet e tyre përmes anketimeve. Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit neni 1 përcaktohen qartë objektivat dhe parimet e funksionimit të këtij programi. Objektivat formues specifike të programit përcaktohen në nenin 3 të kësaj rregulloreje ku shprehet qartë se objektivi kryesor i këtij programi është përgatitja e mësuesve të gjuhës angleze të një niveli të lartë. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Master në Mësuesi "Gjuhë Angleze" me profile me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët) Këta objektiva janë në përputhje me objektivat strategjike të përcaktuara në planin strategjik të Kolegjit Universitar "BEDËR" (Evidenca nr. 8 Plani strategjik institucional i KU "BEDËR" 2018-2022)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se Statuti i KU "BEDËR" dhe të gjitha rregulloret e strukturave, pjesë përbërëse e organigramës së institucionit përcaktojnë qartë rolin dhe funksionin që kryen njësia bazë. Në nenin 5 të Rregullores së Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë përcaktohet roli i departamentit si njësi bazë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Po në këtë nen përcaktohen edhe detyrat bazë të departamentit për nxitjen, bashkërendimin, organizimin dhe administrimin e mësimdhënies me atë kërkimore-shkencore dhe shfrytëzimin e burimeve financiare dhe materiale të vëna në dispozicion të tij. (Evidenca nr. 6 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë).</p> <p>Në kuadër të nxitjes dhe përkrahjes së veprimtarisë dhe kërkimit shkencor, njësia bazë kërkon që anëtarët e departamentit të marrin</p>

	<p>pjesë aktive në angazhime të kësaj natyre. Në nenin 6 të “Udhëzimit për nxitjen e publikimeve shkencore” e më konkretisht te raporti i mbështetjes dhe financimit, përcaktohen procedurat e aplikimit që stafi akademik duhet të ndjekë për të siguruar burimet e financimit të siguruara nga institucioni. (Evidenca nr 34 Udhëzim për nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ konstaton se një nga synimet e njësisë bazë për shtimin dhe gjallërimin e veprimtarisë së kërkimit shkencor është edhe nxitja dhe motivimi që u bëhet studentëve për pjesëmarrje në konferenca shkencore, projekte, trajnime dhe shkolla verore.</p> <p>Nga të dhënat statistikore të paraqitura ne dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVV rezulton se angazhimi i studentëve të programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Gjuhë Angleze është si vijon; 4 studentë të aktivizuar në projekte personale të pedagogëve; 3 studentë të aktivizuar në projekte shkencore në rang Departamenti; 7 studentë të angazhuar në projekte në rang fakulteti. (Evidenca Aneks RVB, Tabela 2, Evidenca nr 36 Raport vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2021-2022)</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin mbështetës, GVJ konstaton se njësia bazë harton çdo vit një projekt buxhet të nevojave dhe kërkesave për financim nga institucioni. (Evidenca nr. 77 Projekt buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze)</p> <p>Një prej zërave të parashikuara në projekt buxhet i dedikohet Kërkimit Shkencor (Research and Development) dhe më konkretisht financime për botime shkencore, pjesëmarrje për konferenca dhe seminare, trajnime personeli. Nga sa u shprehën dhe drejtuesit e institucionit dhe anëtarët e stafit pedagogjik, institucioni shpreh angazhimin për sigurimin e mbështetjes financiare për veprimtaritë e lidhura me kërkimin shkencor. (Evidenca nr. 72 Procedura e mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca nga KU Beder)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rregullorja e programit të studimit përcakton objektivat dhe parimet e funksionimit të këtij programi të cilët janë në përputhje me objektivat strategjike të Kolegjit Universitar “BEDËR”. Në Rregulloren e Njesisë Kryesore përcaktohen detyrat kryesore të departamentit. Një nga synimet e njësisë bazë është edhe nxitja dhe motivimi që u bëhet studentëve për pjesëmarrje në konferenca shkencore, projekte, trajnime dhe shkolla verore. Projekt buxheti për kërkesat për financim nga institucioni përfshin edhe mbështetjen për Kërkimin Shkencor dhe financime për botime shkencore, pjesëmarrje për konferenca dhe seminare, trajnime</i></p>

	<i>personeli.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Në kuadër të përmbushjes së objektivave strategjike për kërkimin shkencor, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulloren mbi projektet kërkimore dhe shkencore në të cilën përcaktohet mënyra e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve kompetente, veprimtaritë individuale dhe përfshirjen e studentëve. (Evidenca nr. 41 Rregullorja mbi projektet kërkimore dhe shkencore) GVJ konstatoi se njësia bazë ka organizuar konferencën ICESS, trajnime të ndryshme, leksione të hapura ndër të cilat; Orë e hapur me Peter Schadt, Ph.D, University of Tübingen, Ëëbinare nga Educators Ëëithout borders, Trajnime të zhvilluara nga Prof. Dr. Ëëoei Hung etj.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	GVJ konstaton se njësia bazë dhe ajo kryesore nxit, motivon dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për të marrë pjesë aktive në veprimtaritë e kërkimit shkencor. Në kuadër të realizimit të këtyre objektivave, njësia bazë organizon një konferencë shkencore dhe boton periodikisht një revistë me karakter shkencor. [http://bjes.beder.edu.al; http://bjh.beder.edu.al]
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, GVJ konstaton se njësia bazë organizon një konferencë shkencore ICESS dhe boton në mënyrë periodike revistën BJH e cila përfshin kontributin dhe veprimtarinë në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik dhe studentëve. (Evidencë nr 36 Raport vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2021-2022)
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe	Një nga objektivat prioritarë të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e njësisë kryesore, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është edhe hartimi i një kurrikule që synon formimin e profesionistëve të fushës të cilët

ndërkombëtar të punës.	falë aftësive të fituara gjatë studimeve në këtë cikël studimi do të jenë të aftë të konkurojnë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.		
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Njësia bazë ka krijuar një rrjet të gjërë bashkëpunimi me rrjete të ndryshme profesionistësh dhe ekspertësh në përpjekje për të përditësuar kurrikulën në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe përfundimit të aftësive dhe kompetencave të nevojshme veçanarisht atyre të nevojshme për të siguruar marrjen e licensës për të ushtruar profesionin e mësuesit. Në këtë kuadër GVB vlerëson si një nga bashkëpunimet më frutdhënëse atë me British Council., Educators across borders, disa qendra të mësimdhënies së gjuhëve të huaja etj. (Evidenca nr. 84 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe mobilitetet për staf dhe student)		
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Bazuar tek dokumentacioni i paraqitur në përmbajtjen e DVV, GVJ konstaton se kurrikula e hartuar për këtë program studimi mbështetet tërësisht në aktet ligjore të RSH dhe është në përputhje të plotë me kuadrin rregullator dhe direktivat e përcaktuara nga BE.		
Konkluzione	<i>Njësia bazë ka hartuar planin për projektet kërkimore-shkencore. Kjo njësi motivon dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për të marrë pjesë në veprimtaritë e kërkimit shkencor. Departamenti ka organizuar një konferencë shkencore, trajnime të ndryshme, leksione të hapura, ëbinare dhe boton periodikisht një revistë me karakter shkencor. Kurrikula e këtij programi studimi synon formimin e profesionistëve të fushës të aftë për të konkuruar në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar. Njësia bazë ka krijuar një rrjet të gjërë bashkëpunimi me rrjete të ndryshme profesionistësh dhe ekspertësh në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Kurrikula e hartuar për këtë program studimi mbështetet në aktet ligjore të RSH dhe është në përputhje me kuadrin rregullator dhe direktivat e përcaktuara nga BE.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Shkalla e përmbushjes së	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
---------------------------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës II	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ konstaton bazuar në dokumentacionin shoqëruar në DVV dhe informacionin në RVB, se programi i studimit “Master profesional”, në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profilet: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët” është i organizuar me 120 kredite sipas sistemit (ECTS), realizohet me kohë të plotë në dy vite akademike dhe i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). (Evidenca nr. 22 Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional”; Evidenca nr.4 – Dokumentacioni shtesë- Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB).</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, ofrohet me dy plane mësimore respektivisht për secilin profil, të cilët janë organizuar kryesisht në përputhje me licensimin e programit të studimit dhe VKM 41/2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë format e mësimdhënies”. GVJ konstaton se në kuadrin e përgjithshëm të veprimtarive formuese (A-E) dhe në planin mësimor të programit të studimit janë përfshirë: leksionet dhe seminarët me numrin përkatës të krediteve sipas strukturës mësimore në semestra (sem. I-rë dhe i II-të), për secilin vit akademik, praktika mësimore me 12 kredite dhe detyrimet përmbyllëse (teza e diplomës) me 18 kredite. Në këtë program studimi nuk janë përfshirë labororet (Evidenca nr.4 – dokumentacioni shtesë. Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas</p>

	<p>veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB). GVJ konstaton se detyrat e kursit, esetë, projektet janë parashikuar në syllabuset e lëndëve, gjithashtu zhvillohen orë të hapura të mësimit nga lekorë të ftuar të cilat janë parashikuar nga njësia bazë (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit; Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022; Evidenca nr. 61 Orë e Hapur me Peter Schadt Ph.D, University of Tubingen).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimit dhe mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ konstaton nga vizita në institucion, konkretisht në takimin me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, si dhe studentët e këtij programi studimi, se personeli akademik i përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve duke ndërthurur format klasike dhe alternative të mësimit dhe mësimdhënies të mundësuar nga përdorimi i teknologjisë si krijimi i klasave virtuale të llojit “google classroom” ose përdorimi i sistemit BIS dhe rrjeteve sociale të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës angleze, shpërndarja e informacionit në “google drive”. Dokumentimi i informacionit mësues realizohet në forma vizuale nëpërmjet infrastrukturës që KU “BEDËR” ofron, të tilla si: përdorimi i burimeve në internet; përdorimi i bibliotekës digjitale J-store, zhvillimi i procesit mësues nëpërmjet tabelave digjitale “Smart Boards”. (Evidencë - Vizita në institucion; RVB-Aneks Tabela 16/17; Shtojca 1- Mjediset dhe infrastruktura e KU “BEDËR”).</p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” mbështetur në licensimin e tij, si dhe aftësitë e certifikuar në gjuhën angleze të personelit akademik (disa prej tyre janë lektorë me kombësi të huaj), i janë përgjigjur larmisë dhe nevojave të studentëve për të zhvilluar programin e studimit në gjuhën angleze (Evidenca nr. 22 Urdhër për Hapjen e Programit të Studimit “Master profesional”). Pavarësisht se në rregulloren themelore të KU “BEDËR”, Neni 86, është parashikuar që programet e studimit mund të zhvillohen në disa gjuhë, GVJ evidenton mangësinë e këtij parashikimi në Nenin 5 të rregullores së programit të studimit, e cila përcakton se programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me</p>

	<p>profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, zhvillohet në gjuhën shqipe (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”; Evidenca Nr. 5 Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” mbështet personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” duke ju krijuar mundësinë e pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, leksione të hapura të zhvilluara nga institucioni, si edhe për të botuar në Revistën shkencore të institucionit, “Bedër University Journal of Educational Sciences” (https://bjes.beder.edu.al/), duke u përjashtuar nga detyrimi financiar për tarifën përkatëse. GVJ vlerëson që Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ka angazhuar personelin akademik në konferencën ndërkombëtare ICESS 2022, të cilën e ka realizuar në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani”, “Educators eithout Borders, Inernational” dhe Shoqatën “ELTA” (Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022).</p> <p>GVJ konstaton se KU “Bedër” nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione partnere në projektet Erasmuss në Kroaci dhe Rumani ka mundur të realizojë një (1) mobilitet të personelit akademik (PA) të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” në Javën Ndërkombëtare Erasmuss në Rumani (Evidenca nr. 97 Rast Shkëmbimi i Stafit Akademik). GVJ konstaton se nga pikëpamja e infrastrukturës, KU “Bedër” ka siguruar përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik, duke ofruar burimet e duhura didaktike në formatin fizik dhe elektronik si: kompjutera (desktop), akses në llogaritë e tyre elektronike në domain-in institucional e.mbiemër@beder.edu.al, përdorimi i sistemit BIS, shfrytëzimi i bibliotekës digjitale dhe fizike, përdorimi i mjeteve didaktike të teknologjisë së avancuar në mësimdhënie si “Smart Boards” (Evidencë – Vizita në institucion; Shtojca 1- Mjediset dhe infrastruktura e KU “BEDËR”).</p>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.

Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

GVJ konstaton se personeli akademik i përket për nga formimi dhe specializimi fushës së edukimit dhe gjuhës angleze. **(Evidenca nr. 16 CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit).** Bazuar tek dokumentacioni plotësues përcjellë përmes DVV dhe shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” për vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga nëntë (9) personel akademik efektiv, (PAE), nga të cilët një (1) është me titullin “Profesor i Asociuar”; pesë (5) me gradën shkencore “Doktor” dhe tre (3) “Master i Shkencave”; ndërsa për vitin akademik 2022-2023, përbëhet nga shtatë (7) personel akademik efektiv, (PAE), nga të cilët një (1) është me titullin “Profesor i Asociuar”; pesë (5) me gradën shkencore “Doktor” dhe një (1) “Master i Shkencave”, **(Ref. tabelat 6.1 dhe 6.2 RVB).**

GVJ evidenton se nga pikëpamja ligjore, personeli akademik me kualifikimin “Master i Shkencave” i angazhuar në programin e studimit shkon ndesh me Ligjin 80/2015, Neni 59, pika 6, i cili parashikon se personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

Referuar kualifikimit të PAE, GVJ konstaton se në mësimdhënie për këtë program studimi është angazhuar vetëm një (1) personel akademik me titullin Profesor i Asociuar, që sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL 80/2015, neni 59, pika 3, është titullar i lëndëve apo moduleve dhe udhëheq veprimtarinë kërkimore-shkencore **(Referuar Ligjit 80/2015 NENI, 59, pika 3; Ref. tabelat 6.1 dhe 6.2 RVB; Evidencë- Tabela 2 Personeli Akademik për njësinë bazë; Evidenca nr.10 – Dokumentacioni shtesë -Ngarkesa totale vjetore te oreve te mesimit te PA te angazhuar ne mesimdhënie ne kete program studimi).**


KU “Bedër” ka angazhuar lektorë të huaj të pajisur me gradën “PhD” në programin e studimit Master Profesional në Mësuesi Gjuhë Angleze me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” në përputhje me ligjin e punësimit dhe ligjin për arsimin e lartë në vend, të cilët kanë dhënë një kontribut në drejtim të eksperiencës ndërkombëtare në arsimin e lartë. Përzgjedhja e personelit

	<p>akademik dhe ngarkesa mësimore për vitin akademik përkatës realizohet me vendim të Këshillit të Departamentit. (Evidenca nr. 16 CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit; Evidenca nr. 71 Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 23 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>GVJ vlerëson se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës angleze, si njësi përgjegjëse, e cila ofron programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të ulët”, në bashkëpunim me NJSBC-në është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet aplikimit të anketimeve të studentëve me objektiv kurrikulën dhe lëndën, process i cili zhvillohet para fillimit të sezonit të provimeve dhe u evidentua nga takimi në institucion me studentët e programit të studimit (Evidenca nr. 96 Anketë vlerësimi të studentëve për programin e studimit).</p> <p>GVJ gjithashtu konstaton se personeli akademik kryen procesin e vetë vlerësimit nëpërmjet plotësimit të formularit për stafin akademik, i cili përmban rubrika për kërkimin shkencor, mësimdhënien, nevojat për zhvillim personal dhe objektivat për të ardhmen (Evidenca nr. 31 Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqëruar i RVB-së se KU “Bedër” ka ngritur struktura të posaçme për monitorimin dhe garantimin e cilësisë në nivel institucional si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit” (KPGSCIPS); - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, (NJSBC); <p>Këto dy struktura, së bashku me Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore bashkëveprojnë në mbështetje të eksperimentimit dhe zhvillimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. (Evidenca nr.5-Dokumentacioni shtesë-Vendim Senati për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për KPGSC dhe NJSBC-së; Evidenca nr. 29 Shkresa nga NJSBC te HR).</p>

përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.									
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit "Master profesional", në "Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profilet: "Mësues për arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për arsimin e mesëm të ulët", që KU "Bedër ofron, është i organizuar me 120 kredite sipas sistemit (ECTS), realizohet me kohë të plotë në dy vite akademike dhe i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe ofrohet me dy plane mësimore respektivisht për secilin profil, të cilët janë organizuar kryesisht në përputhje me licensimin e programit të studimit dhe VKM 41/2018 për "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë format e mësimdhënies". GVJ vlerëson se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës angleze, si njësi përgjegjëse, e cila ofron programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile "Mësues për Arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët", në bashkëpunim me NJSBC-në është angazhuar në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet aplikimit të anketimeve të studentëve me objektiv kurrikulën, lëndën, personelin akademik dhe institucionin.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB-së, se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale për programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi, Gjuhë Angleze" me profile "Mësues për Arsimin e mesëm të lartë" dhe "Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët", përcaktohen në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit të tilla si: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë dhe Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër". Këto rregullore kanë përcaktuar se vlerësimi i studentit shprehet me disa forma:


	<p>sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me notë dhe me fjalë; sipas vlerësimit të brendshëm të KU “Bedër” shprehen me pikë, me shkronjë dhe mesataren e ponderuar, (GPA). Sipas këtij sistemi vlerësimi një student rezulton kalues me vlerësimin me notën 5, piket 45-49, shkronja D dhe mesatarja e ponderuar ose koeficienti (1) me shkronjë dhe me mesataren e ponderuar, (GPA) (Evidencë nr.5. Rregullore Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 92; Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 42).</p> <p>GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” përfshin në Nenin 10 të saj format e studimit dhe verifikimin e dijeve, si dhe në nenin 11 parashikon frekuentimin e detyruar në masën 80 % të aktivitetit mësimor në auditor, por nuk ka përfshirë specifikisht sistemin e vlerësimit për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi , gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU” (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”). Nga takimi në institucion studentët u shprehën se janë të informuar për procedurën e vlerësimit në fillim të semestrit ose vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shoqëruar dhe nga vizita në institucion se në fillim të çdo lënde/moduli studentëve u komunikohet metodologjia e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit në përputhje me “Rregulloren Themelore” të KU “Bedër” dhe Rregulloren e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë”. (Evidencë nr.5. Rregullore Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”; Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).</p> <p>GVJ konstaton se syllabuset përcaktojnë format e kontrollit të dijeve të ndara në kategoritë: ‘Frekuentim’; ‘Vlerësimi i vazhdueshëm’ dhe ‘Vlerësimi i ndërmjetëm’ (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit). Në rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, neni 45 parashikohet se brenda javës së parë të çdo semestri pedagogët duhet të publikojnë sistemin e vlerësimit, si dhe të publikojnë rezultatet në faqet personale të studentëve në sistemin BIS.</p> <p>(Evidencë nr.5. Rregullore Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 92; Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 45).</p> <p>GVJ konstaton se në rregulloret e institucionit nuk është</p>



	<p>përcaktuar ponderimi përqindjes/pikëzimit midis vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit final të lëndës. Në syllabuset e lëndëve rezulton se vlerësimi i kontributit vjetor shkon maksimalisht deri në 80% në disa lëndë. Ndërsa, provimi final varion maksimalisht në masën 60% konkretisht, në rastin e lëndës “Zhvillim Kurrikule”, ose minimalisht në masën 20% në rastin e lëndës “Metodat në mësimdhënien e aftësive gjuhësore të gjuhës angleze në AML/AMU” (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit</p> <p>GVJ konstaton nga dokumentacioni shtesë i paraqitur në ASCAL, se në tabelën 15 për format e kontrollit të njohurive janë përcaktuar pjesët në përqindje për çdo formë vlerësimi, ku vërehet se provimi përfundimtar zë nga 30-50% të totalit (Evidenca nr.9 – dokumentacioni shtesë- Tabela 15 për format e kontrollit të njohurive).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive dijeve dhe aftësive profesionale dhe përlogaritja e vlerësimit për lëndët përkatëse për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, përcaktohet nga titullari i lëndës dhe në fillim të vitit akademik/semestrit. Procedura vlerësimit të njohurive dhe sistemi i pikëzimit për vlerësimin e lëndës është përcaktuar në syllabuset e lëndëve sipas VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”, ku evidentohet se titullarët e lëndëve kanë përfshirë disa tipologji të kontrollit të njohurive si: projekte, quize, gjysmë finale, projekte semestrale. GVJ rekomandon që institucioni të përcaktojë në rregulloret e brendshme, sidomos në rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë” dhe Rregulloren e programit të studimit “Master profesional” sistemin e pikëzimit të shprehur në përqindje për format e kontrollit të njohurive, kryesisht për dy kategori: vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin final. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”; Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB-së, se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues</i></p>

	<p>për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, përcaktohet në kuadrin rregullator të brendshëm të institucionit: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë dhe Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”. Këto rregullore kanë përcaktuar se vlerësimi i studentit shprehet me dy forma:</p> <p>sipas sistemit shqiptar të vlerësimit me notë dhe me fjalë;</p> <p>sipas vlerësimit të brendshëm të KU “Bedër” shprehet me pikë, me shkronjë dhe mesataren e ponderuar, (GPA). GVJ konstaton se studentët informohen nga pedagogët për format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimin e tyre në fillim të semestrit ose vitit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulet.</p>	<p>GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve, të cilët ndjekin programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, është në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”. Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij program studimi është rezultat i tre treguesve: 1-vlerësim i vazhduar/frekuentim (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik, zhvillimi i projekteve, quizeve, detyrave të kursit) 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/ vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: provime gjysmë finale, projekte semestrale, 3-vlerësimi me anë të provimit final (Evidencë nr.5. Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 78.pika 5). Frekuentimi i detyruar në masën 80% i lëndëve për programet e studimit të ciklit të dytë është parashikuar në Nenin 84 të Rregullores themelore të KU “Bedër”.</p> <p>Vlerësimi i raporteve për ponderimin e përqindjes për secilën rubrikë vlerësimi, bëhet nga pedagogu i lëndës dhe nuk diktohet</p>

	<p>nga përcaktime në rregulloret e institucionit, pasi këto të fundit nuk e kanë të përcaktuar kufirin e pikëzimit ose përqindjes për vlerësimin e vazhduar dhe vlerësimin final. GVJ e konstatoi këtë gjetje edhe nga takimi me personelin akademik, të cilët pohuan se në programin e lëndës janë të shprehura modalitetet e vlerësimit të vazhduar, vlerësimit final dhe detyrimet e studentit, të cilat u bëhen të ditura në fillim të procesit mësimor. (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit). GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” përfshin në Nenin 10 të saj format e studimit dhe verifikimin e dijeve, si dhe në nenin 11 parashikon frekuentimin e detyruar në masën 80 % të aktivitetit mësimor në auditor, por në këtë rregullore nuk është përfshirë specifikisht sistemi i vlerësimit për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi , gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU” (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” aplikon platformën elektronike BIS, një sistem i brendshëm për ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave për studentët, personelin akademik dhe sekretarinë mësimore, e cila mundëson publikimin e rezultateve të provimit, https://bis.beder.edu.al (Evidenca nr. 35 Udhëzues i Sistemit Informativ BIS).</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ u informua nga takimi me personelin akademik në institucion dhe referuar dokumentacionit në DVV se format e kontrollit të njohurive dhe pikëzimi për to janë parashikuar qartë nga pedagogu në syllabuset e lëndëve në përputhje me VKM 41, dt. 24.1.2018 “Për elementët e Programeve të studimit të ofruar nga IAL”. Vlerësimi përfundimtar në lëndët e këtij program studimi është rezultat i tre treguesve: 1-vlerësim i vazhduar/frekuentim (aktivizimi në seminare dhe leksione gjatë semestrit vitit akademik, zhvillimi i projekteve, quizeve, detyrave të kursit); 2-vlerësimi i ndërmjetëm gjatë semestrit/vitit akademik për elementët e përcaktuar në programin e lëndës të llojit: provime gjysmë finale, projekte semestrale, 3-vlerësimi me anë të provimit final (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit; Evidencë nr.5. Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 78.pika 5).</p> <p>GVJ u informua se nga takimi me PA se përlllogaritjen e vlerësimit përfundimtar të lëndës e kryen automatikisht sistemi BIS, në bazë të pikëve që pedagogu raporton në sistem. Studenti</p>

	njihet me vlerësimin përfundimtar të lëndës në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, e reflektuar në rregulloret e brendshme të institucionit (Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 38/45).
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Referuar takimit në institucion me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente dhe këshilla mbi procesin e të nxënies, kryesisht përgjatë vlerësimit të vazhduar, konkretisht për rezultatet në detyrat e kursit, projektet dhe provimet gjysmë finale për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen (Evidenca nr. 42 Guida e Stafit, fq.19-20).
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	KU "BEDËR" ka hartuar rregullore të posaçme për disiplinën në procesin mësimor, ku është parashikuar shmangia dhe mos lejimi i plagjiaturës, si dhe mos kopjimi në provime dhe detyra (Evidenca nr. 53 Rregullorja e Disiplinës së Studentëve të Kolegjit Universitar "Bedër", Neni 7 dhe 8; Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit "Master profesional", Neni 17).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se rezultatet e studentëve pasqyrohen në proces verbalin e vlerësimit dhe regjistrin e rezultateve. Procesverbali i plotësuar nga pedagogu titullar i lëndës me rezultatin e provimit, dorëzohet në sekretarinë e departamentit përkatës jo më vonë se dy (2) javë nga dita e zhvillimit të provimit (Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 38).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe rishikimin e notës mbështetur në Statut, rregulloren themelore të KU "Bedër", Neni 102, dhe Rregulloren Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të dytë, Neni 36. (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"; Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të	GVJ konstaton se studentët kanë të drejtën të ankimojnë rezultatin e provimit brenda një (1) jave nga dita e publikimit të rezultatit, duke paraqitur një ankesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore. Me vendim të Këshillit të Departamentit ngrihet komisioni me tre pedagogë, ku nuk është pjesë pedagogu i

jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	lëndës dhe vendimi i bëhet i ditur studentit brenda 15-ditëve nga paraqitja e kërkesës (Evidencë nr. 5 Rregullore Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër” ; (Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë). Procedura e ndjekur është transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet (Evidenca nr. 88 Procedurë për Ankimimin e Notës).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU “Bedër” mbështetur në Statut dhe rregulloren themelore të tij, Neni 102, siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. GVJ konstaton se studentët kanë të drejtën të ankimojnë rezultatin e provimit brenda një (1) jave nga dita e publikimit të rezultatit, duke paraqitur një ankesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore. GVJ konstaton se KU “BEDËR” aplikon platformën elektronike BIS, një sistem i brendshëm për ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave për studentët, personelin akademik dhe sekretarinë mësimore, i cili mundëson publikimin e rezultateve të provimit, https://bis.beder.edu.al.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	GVJ konstaton nga shqyrtimi i referencës në dokumentacionin shtesë të paraqitur pas vizitës në institucion së kuadrit të përgjithshëm formues për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, të miratuar me Vendim nr.1, datë 11.07.2021 të Senatit të KU “BEDËR” dhe licensuar nga MAS me Urdhër nr. 373, datë 23.09.2021 se veprimtaria formuese e programit të studimit është në përputhje me VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”, për kategorinë “Master Profesional”: - lëndët bazë (A) zënë 10 % / 12 kredite nga referenca e detyrimit ligjor për Masterin Profesional (5%-10%)

ECTS;

- lëndët karakterizuese (B) zënë 40 %/ 48 kredite nga referenca (30%-40%);
- lëndët ndërdisiplinore (C) zënë 25 % / 30 kredite nga referenca (20%-30%);
- lëndët plotësuese (D) zënë 10 % / 12 kredite nga referenca (10%);
- detyrimet përmbyllëse (E) zënë 15%/ 18 kredite nga referenca (10-20%).

(Evidenca nr.4 –Dokumentacioni shtesë- Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB; VKM 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga IAL-të”; Evidenca nr. 27 Procedurë e Praktikës Profesionale).

GVJ konstaton se orët e studimit individual, të cilët përlllogaritin veprimtarinë e përgatitjes së punimeve të relacioneve, detyrave të kursit dhe projekteve, (parashikuar në VKM 41/2018) janë përfshirë vetëm për njërin profil të programit të studimit, konkretisht për planin mësimor “Mësuesi në Gjuhë Angleze” në “AMU”, konkretisht 90 orë për secilën lëndë. **(Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”; Evidencë- Tabela 10 Aneks RVB- Plani mësimor”)**. GVJ konstaton në dokumentacionin shtesë se orët e studimit individual nuk janë përfshirë në planet mësimore “AML”/”AMU” **(Evidenca nr.4 –Dokumentacioni shtesë- Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB)**.

GVJ rekomandon që të unifkohet plani mësimor në Rregulloren e programit të studimit “Master profesional”.

GVJ pasi verifikoi dokumentacionin të paraqitur nga institucioni në fund të vizitës dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur në ASCAL lidhur me kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit të miratuar nga MAS, rekomandon që ai të vendoset në Rregulloren e programit të studimit, pasi GVJ vëren se aty nuk është pasqyruar kuadri i miratuar në licensimin e programit të studimit **(Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”; Evidenca nr.4 –**

	Dokumentacioni shtesë- Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	GVJ konstaon se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit duke përfshirë në planet mësimore të programit Master Profesional të dy profileve “AML” dhe “AMU”, lëndë ndërdisiplinore/integruese si: Komunikimi dhe Etika në institucionet arsimore – kategoria C; teknologjitë mësimore në edukim; zhvillim i kompetencave ndërkulturore në mësimdhënie; mësimdhënia përmes kulturës; ose lëndë karakterizuese për disiplinën/kategoria B:“Aftësi gjuhësore të integruara”.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të përfshira në programin e studimit analizohen në përfundim të lëndës. Kjo gjetje konkretizohet me plotësimin e formularit të vetë vlerësimit që kryen pedagogu i lëndës, si dhe me anketën që plotëson studenti në përfundim të vitit akademik, para sezonit e provimeve. Nga takimi në institucion me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse përcaktohet nga titullari i lëndës dhe u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik/semestrit, në përputhje me “Rregulloren Themelore” të KU “BEDËR” dhe Rregulloren e Studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë” (Evidenca nr. 33 Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët; Evidenca nr. 96; Ankete vleresimi te studenteve per programin e studimit; Evidenca nr. 62 Anketa e Stafit Akademik; Evidencë nr.5. Rregullore Themelore të Kolegjit Universitar “Bedër”, Neni 92; Evidencë nr.4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 42).
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli	Duke iu referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV, konkretisht, planit mesimor të programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, programeve të lëndëve/syllabuset, si dhe nga takimi me PA dhe studentët, GVJ konstaton se mësimdhënia realizohet mbi bazën e kompetencave, të cilat janë parashikuar

<p>akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>në formën e realizimit të detyrave të kursit, projekteve, eseve, prezantimit të projekteve semestrale, interaktivitetit në orën mësimore nëpërmjet formës së praktikës në rolin e mësuesit etj. Për të garantuar këtë objektiv realizohet procesi i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies (Evidenca nr. 54 Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies). GVJ konstaton se zhvillimi i praktikës mësimore në këtë program studimi zë 10 % të krediteve totale, në kategorinë e lëndëve plotësuese (D) dhe nuk ka lënë hapësirë për lëndë të tjera plotësuese si gjuhë e huaj apo njohuri kompjuterike (Evidenca nr.4 –Dokumentacioni shtesë- Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB).</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi dhe është në proces për zbatimin e tyre, kryesisht për të rritur mobilitetin e studentëve, pasi në këtë program studimi nuk rezultojnë ende programe shkëmbimi të zbatuara për kategorinë e studentëve. (Evidenca nr. 97 Rast Shkëmbimi i Stafit Akademik; Evidenca nr. 84 Lista me Marrëveshjet e Bashkëpunimit (aktive) dhe Mobiliteti për Staf dhe Studentë me Institucionet Homologe, brenda dhe ose jashtë Vendit Evidenca nr.13 – Dokumentacioni shtesë-Të dhëna për mobilitetin e stafit akademik te programit te studimit).</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se personeli akademik dhe kryesisht lektorë të ftuar në KU “BEDËR” kanë realizuar orë të hapura dhe seminare extra kurrikulare mbi “Kompetencat e komunikimit ndërkulturor”; “Përdorimi i platformës SPSS”; “Research gaps to hypothesis”; “Humanities and digitalization” (Evidenca nr. 64 Plani i Aktiviteteve të Departamentit 2022-2023; Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022.).</p> <p>Lektorë të Departamentit të Edukimit dhe Gjuhëve Angleze ofrojnë trajnime të specializuara në fushën e edukimit, të cilat janë të certifikuara me kredite për kategorinë e specialistëve të arsimit, drejtuesve të shkollave dhe mësuesve, ku përmendet Moduli “Zhvillimi moshor i fëmijëve dhe të rinjve”, etj., (Evidenca nr. 92 Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara nga Prof. Dr. Ëoei Hung, bashkë me linqet përkatëse).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka mbështetur studentët në zhvillimin e ideve kërkimore dhe nga ana financiare, duke i</p>

<p>studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>angazhuar në punë kërkimore dhe përfshirë ata në ngjarje të rëndësishme shkencore, sic është Konferenca Ndërkombëtare ICESS II, e organizuar nga Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze. Studentët e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, kanë patur mundësi të marit pjesë si bashkëautorë me pedagogët e tyre në këtë konferencë duke përjashtuar tarifën e regjistrimit. Gjithashtu studentët në përgjithësi mbështeten të marit pjesë në konkurse të ndryshme, si dhe në projektet që mundëson institucioni (Evidenca nr. 72 Procedura e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU Bedër; Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Bedër, 2018-2023).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile: “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, nëpërmjet kuadrit të përgjithshëm të veprimtarive formuese dhe planit mësimor të tij, të specifikuar për secilin profil, garanton thellimin e njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore të studentëve në fushën e mësuesisë në gjuhën angleze. GVJ konstaton se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit duke përfshirë në planet mësimore të programit Master Profesional të dy profileve “AML” dhe “AMU”, lëndë ndërdisiplinore/integruese. GVJ konstaton se zhvillimi i praktikës mësimore në këtë program studimi zë 10 % të krediteve totale në kategorinë e lëndëve plotësuese (D) dhe nuk ka lënë hapësirë për lëndë të tjera plotësuese si gjuhë e huaj apo njohuri kompjuterike. GVJ konstaton një mospërputhje në dokumentacion për sa i përket përfshirjes së orëve të studimit/punës individuale, në planin mësimor “Mësuesi, Gjuhë Angleze” në “AMU”/ “AMU”, të cilët përlllogaritin veprimtarinë e përgatitjes së punimeve të relacioneve, detyrave të kursit dhe projekteve, (parashikuar në VKM 41/2018).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, kryhet me punim diplome, sipas Nenit 39/40/41 të Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, e cila parashikon procedurën e mbrojtjes së temës së Diplomës për Masterin Profesional. Studenti fillon tezën e diplomës në semestrin e dytë ose të katërt dhe përfiton 18 kredite (ECTS) në përfundim të saj. (Evidencë nr.4, Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë). Rregullorja themelore e KU “BEDËR”, Neni 108, pika A, parashikon se detyrimet përmbyllëse realizohen nga studentit vetëm në rastin kur ai ka kaluar me sukses të gjitha lëndët e programit mësimor dhe nuk ka asnjë notë të vlerësuar (D- ose F). Gjithashtu Rregullorja e Programit të studimit parashikon në Nenin 15 procedurën e udhëheqjes së mikrotezes, në të cilën është përcaktuar se udhëheqësi i mikrotezës ka të paktën gradë “Doktor i Shkencave”, është i profilizuar në fushën studimore e programi të studimit dhe mund të udhëheqë deri në 10 studentë. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”). GVJ konstaton se rregullat dhe procedurat e diplomimit u bëhen të ditura studentëve nga koordinorët e programit të studimit si dhe janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka hartuar Manualin për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë, e cila përmban elementë të detajuar për punimin e mikrotezës (Evidenca nr. 73 Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë). Gjithashtu, në Nenin 40 të rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, është parashikuar që bashkërenduesi i programit të studimit Master Profesional i propozon Dekanatit të fakultetit një udhëheqës të mikrotezës për secilin student në fillim të semestrit të tretë dhe temën e tezës së përcaktuar nga udhëheqësi në fillim të semestrit të fundit. (Evidencë nr.4, Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i</p>	<p>GVJ konstaton se për administrimin e mbrojtjes së diplomës,</p>



<p>posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>ngrihet një komision i posaçëm/ Juria me jo më pak se tre (3) persona (një nga të cilët është udhëheqësi i tezës) dhe një zëvendësues. Kjo juri përcaktohet ose ndryshon me vendim të Dekanatit sipas propozimit të departamentit të Edukimit dhe gjuhës angleze, i cili më pas miratohet në Dekanat. (Evidencë nr.4 , Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 41,pika b/c/d)</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>GVJ konstaton se përpos udhëheqësit të temës, në orientimin e studentëve që do të diplomohen në programin e studimit Master profesional, është angazhuar gjithashtu këshilltari akademik, i cili asiton dhe ndihmon studentët në prag të diplomimit. Kjo është parashikuar në manualin e hartuar për detyrat dhe përgjegjësitë e Këshilltarit akademik (Evidenca nr. 49 Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik). GVJ konstaton se Neni 15 i Rregullores së programit të studimit “Master profesional” për procedurën e udhëheqjes së mikrotezes përcakton se udhëheqësi i mikrotezës ka të paktën gradë “Doktor i Shkencave”, është i profilizuar në fushën studimore e programit të studimit, ka njohuri të thelluara teorike dhe aftësi të vecanata kërkimore në fushën që është parashikuar të hartohet teza. Kjo rregullore parashikon se udhëheqësi i mikrotezës mund të udhëheqë njëkohësisht deri në (10) studentë për programin e studimit në fushën e shkencave humane dhe shoqërore, ku konkretisht përfshihet edhe programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” . (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”). Në përputhje me Manualin për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë, udhëheqësi ndjek vijueshmërinë e procesit të hartimit të mikrotezës, duke garantuar cilësinë e rezultateve, e cila raportohet në formularin e ecurisë së tezës, e cila miratohet në përfundim për t'u paraqitur në komisionin e mbrojtjes (Evidenca nr. 73 Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë; Evidenca nr. 81 Formular i Ecurisë së Tezës</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe</p>	<p>GVJ konstaton se përpos Manualit për Përgatitjen e Tezës së Diplomës së Ciklit të Dytë dhe orientimit të plotë nga udhëheqësi i temës së diplomës, një rol të rëndësishëm në ndjekjen e studentëve për kryerjen e testeve dhe analizave për studentët e programin e studimit Master Profesional në</p>

<p>fushës së studimit.</p>	<p>“Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” luajnë dhe këshilltarët akademikë. Në funksion të realizimit të temës, institucioni ka vënë në dispozicion bibliotekën fizike dhe elektronie J-store, si dhe laboratorët që ndodhen në institucion. GVJ nuk ka të dhëna për procedurën e ndjekjes së studentëve jashtë institucionit për punimin e temës së diplomës për programin “Master Profesional”.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ konstaton se “Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë”, parashikon se studenti vlerësohet me notë (4-10) dhe me fjalë sipas sistemit shqiptar të vlerësimit; ndërsa sistemit të brendshëm të KU “BEDËR” vlerësohet me pikë (0-100), me shkronjë (A-F) dhe koeficientin e mesatares së ponderuar GPA (0-4). Në përfundim të mbrojtjes së diplomës për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” përfiton 18 kredite (ECTS) (Evidencë nr.4 , Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 39,40/41). Juria mbledhet jo më vonë se 30 ditë nga dorëzimi i tezës. Mbrojtja e tezës zgjat jo më pak se 45 minuta, përfshirë pyetje dhe përgjigje dhe juria e mer vendimin me shumicë votash dhe e komunikon vlerësimin. Departamenti i edukimit dhe gjuhës angleze njofton fakultetin me anë të process verbalit pas tre ditësh nga marrja e vendimit (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master Professional” Neni 18).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstaton se Neni 54/ 55 i Rregullores së studimeve dhe provimevet të ciklit të dytë, si dhe Neni 108/109 i rregullores themelore të KU “ BEDËR” parashikojnë lëshimin e diplomave Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” dhe suplementit të saj në përputhje me miratimin e tyre nga Senati akademik (Evidencë nr.4 , Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë; Evidenca nr.2 Model i Diplomës dhe Suplementit të Diplomës me vendim Senati; Evidenca nr. 26 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore). Kjo është parashkuar edhe në rregulloren e zyrës së sekretarisë. GVJ konstaton se institucioni është në process për miratimin e formës së diplomës edhe suplementit të saj nga MAS (Evidenca nr.3 Procedurë aplikimi në MAS për miratimin e Formës së Diplomës dhe</p>

	Suplementit të saj).			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar rregulloren e Arkivës e cila dikton ruajtjen në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin, të tilla si provimet dhe procesverbalet origjinale të notave që arshivohen deri në 5 vjet nga data e publikimit të tyre, ndërsa regjistrat e amzës dhe notave që ruhen pa afat nëse kërkohen (Evidenca nr. 38 Rregullorja e Arkivës).			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se përmbyllja e studimeve për programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët”, kryhet me punim diplome, sipas Nenit 39/40/41 të Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, e cila parashikon procedurën e mbrojtjes së temës së Diplomës për Masterin Profesional. Studenti fillon tezën e diplomës në semestrin e tretë dhe përfiton 18 kredite (ECTS) në përfundim të saj. Neni 54/55 i Rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, si dhe Neni 108/109 i rregullores themelore të KU “BEDËR” parashikojnë lëshimin e diplomave Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” dhe suplementit të saj në përputhje me miratimin e tyre nga Senati akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	GVJ u informua nga takimi në institucion se përpos praktikës profesionale, e cila është parashikuar në planin mësimor të programit të studimit dhe zhvillohet në institucione arsimore partnere, personeli akademik zhvillon praktika mësimore në orët e mësimit nëpërmjet improvizimit, punës me role dhe projekteve semestrale. Studentët në këto role drejtohen nga pedagogët e lëndës dhe shfrytëzojnë mjediset dhe infrastrukturën e institucionit, si laboratorët, biblioteka, tabelat inteligjente “smart

	board” për të plotësuar nevojat didaktike (Evidencë- Takimi në institucion; Evidenca nr.4 – dokumentacioni shtesë -Vendim MAS per miratimin e planit mesimor te programit te studimit te ndare sipas veprimtarive formuese & tabela 9 Aneks RVB; Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit; Evidenca nr. 83 Lista e Institucioneve Partnere).
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV dhe referuar informacionit në RVB, GVJ konstaton se KU “BEDËR” ka lidhur tre (3) marrëveshje të posaçme me institucione dhe kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, konkretisht:1. Akademia e Gjuhëve Evropiane; 2. Turgut Ozal Education; 3. Shkolla Jopublike Arbëria; 4. (Evidenca nr. 89 Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institucione Jopublike të Arsimit Parauniversitar). GVJ eidenton pamjaftueshmërinë e numrit të bashkëpunimeve në këtë drejtim, pavarësisht se nga takimi në institucioni GVJ u informua se mundësia e kryerjes së praktikave mësimore ndëmjetësohet nëpërmjet zyrave vendore arsimore, në rastet kur studentët nuk e zhvillojnë praktikën në institucionet me të cilat është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit më këtë fokus (Evidenca nr.7 Procedure per praktikën profesionale). Përpos institucioneve me drejtim arsimor, GVJ konstaton se institucioni ka lidhur dhe 5 marrëveshje të tjera bashkëpunimi me organizata /ndërrmarje publike dhe private, komunitetin e biznesit për praktikën profesionale (Tabela 5 - Aneks RVB).
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	GVJ konstaton se sipas kuadrit të përgjithshëm formues të programit të studimit praktika profesionale, i përket kategorisë D të elementëve të programit të studimit, ka 12 kredite dhe zhvillohet në semestrin e katërt të tij. Ajo organizohet dhe zbatohet në përputhshmëri të dokumentit “Procedura e Praktikës Profesionale” dhe zgjat për një periudhë 12-javore në terren. Rezultatet e praktikës profesionale depozitohen në Dosjen e praktikës së studentit, ku eidentohen: plane ditore, plane vlerësimi, formularë observimi. Studenti praktikant vlerësohet nga pedagogu që ndjek praktikën dhe nga mbikqyrësi në terren. (Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional”, Neni 16; Evidenca nr. 27 Procedurë e Praktikës Profesionale).
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se praktika profesionale në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për</i>

	<i>Arsimin e mesëm të Ulët” zgjat për një periudhë 12-javore në terren, ka maksimumin e mundshëm të krediteve të kategorisë D për lëndët plotësuese, 12 kredite (ECTS). Praktika profesionale zhvillohet sipas “Procedurës së Praktikës Profesionale”. GVJ konstaton se personeli akademik zhvillon praktika mësimore në orët e mësimit nëpërmjet improvizimit, punës me role dhe projekteve semestrare. Studentët në këto role drejtohen nga pedagogët e lëndës dhe shfrytëzojnë mjediset dhe infrastrukturën e institucionit, si laboratorët, biblioteka, tabelat inteligjente “smart board” për të plotësuar nevojat didaktike</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit,	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për programin e studimit Master Profesional në: “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile: “Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” përgjatë dy viteve akademike janë si më poshtë: (Ref. tabelat 6.1 dhe 6.2 RVB)				
	Kualifikimi i stafit akademik të PS	2021-2022		2022-2023	
		PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	-	-	-	-
	Prof. Asoc.	1	-	1	-
Dr/Phd	5	-	5	-	

natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Msc.	3	-	1	-
Gjithsej	9	0	7	0

Bazuar tek dokumentacioni plotësues përcjellë përmes DVV dhe shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master Profesional në “Mësuesi, Gjuhë Angleze” me profile “Mësues për Arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për Arsimin e mesëm të Ulët” për vitin akademik 2021-2022 përbëhet nga nëntë (9) personel akademik efektiv, (PAE), nga të cilët një (1) është me titullin “Profesor i Asociuar”; pesë (5) me gradën shkencore “Doktor” dhe tre (3) “Master i Shkencave”; ndërsa për vitin akademik 2022-2023, përbëhet nga shtatë (7) personel akademik efektiv, (PAE), nga të cilët një (1) është me titullin “Profesor i Asociuar”; pesë (5) me gradën shkencore “Doktor” dhe një (1) “Master i Shkencave”.

GVJ evidenton se nga pikëpamja ligjore, personeli akademik me kualifikimin MSC i anagazhuar në programin e studimit shkon ndesh me Ligjin 80/2015, Neni 59, pika 6, i cili parashikon se personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës (**Evidenca, Aneks RVB Tabela 6.2 Stafit akademik për programin e studimit Master Profesional në Mësues, viti akademik 2022-2023**).

Referuar kualifikimit të PAE, GVJ konstaton se në mësimdhënie për këtë program studimi është angazhuar vetëm një (1) personel akademik me titullin Profesor i Asociuar, që sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në LAL 80/2015, neni 59, pika 3, është titullar i lëndëve apo moduleve dhe udhëheq veprimtarinë kërkimore-shkencore (**Referuar Ligjit 80/2015 NENI, 59, pika 3**).

Referuar të dhënave të bashkangjitura në RVB, për vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze përbëhet nga 8 pedagogë efektivë, 2 staf akademik me kontratë dhe një personel me funksion ndihmës akademik. (**Evidenca nr. 16 CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Evidenca nr. 69 CV e stafit ndihmës akademik, Aneks RVB Tabela 2.2 Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2022-2023**).

<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV vërehet se PAE i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e mesëm të Ulët e mbulon ngarkesën mësimore të zhvilluar në masën 100%. (Evidenca Aneks RVB Tabela 4 Ngarkesa mësimore për programin e studimit Master në Mësuesi ; Tabela 6.2 Stafit akademik për programin e studimit Master në Mësuesi Gjuhë Angleze)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Pasi shqyrtoi CV e personelit akademik të punësuar pranë Departamenti të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, përgjegjës për programin e studimit, Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët, pjesë e dokumentacionit plotësues të përfshirë në DVV, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar është punësuar mbi bazën e të gjithë kritereve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër GVJ gjatë vizitave në institucion shqyrtoi dhe disa dosje të stafit akademik të punësuar dhe konstatoi se ishin ndjekur të gjitha hapat e procedurës për rekrutimin e personelit akademik. (Evidenca nr. 16 CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Evidencë nr. 74 Dosja e stafit akademik; Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i dhënë në DVV, Zyra e Burimeve Njerëzore pranë KU Beder, është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët.</p> <p>Pasi shqyrtoi nga afër gjithë dokumentacionin e paraqitur nga Zyra e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se kjo strukturë dispononte të gjitha të dhënat dhe informacionet për stafin akademik, përfshirë edhe kontratat e punësimit dhe mbulimet e detyrueshme nga sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. (Evidenca nr. 16 CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Evidenca nr. 74 Dosja e stafit akademik]</p>
	<p>Nga shqyrtimet e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se njësia bazë ka përcaktuar dhe hartuar procedurat dhe kriteret e veçanta për rekrutimin e personelit duke pasur parasysh nevojat e programit, specifikat e</p>

	tij dhe kriteret e vendit të punës.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të paraqitur në DVV dhe duke marrë parasysh faktin se në këtë program studimi nuk janë të programuara për tu zhvilluar orë laboratorike, në strukturën mbështetëse dhe bazën logjistike të ofruar për këtë program studimi nuk është vënë në dispozicion personel ndihmës akademik. GVJ konstatoi se me qëllim mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e pajisjeve dhe infrastrukturës në përgjithsi angazhohen ekspertë të fushave të ndryshme, në varësi të detyrave që kryejnë. (Aneks RVB, Tabela 9, Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese)
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Bazuar tek informacioni i dhënë në Dosjen e Vlerësimit të Brendshëm, Zyra e Burimeve Njerëzore siguron dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik. Kjo strukturë administron çdo vit dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik, GVJ konstaton se ato përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nisur nga të dhënat personale e më pas të dhëna mbi kualifikimet e tyre të përditësuara në mënyrë periodike, si dhe kontratën e punës. Referuar të njëjtave burime, në fillim të çdo viti akademik përcaktohet ngarkesa mësimore për stafin akademik. GVJ konstatoi se ngarkesa mësimore e stafit akademik të angazhuar për programin e studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët përcaktohet nga njësi bazë dhe është miratuar mbështetur në udhëzimin nr. 1, datë 02.09.2022 të Senatit Akademik të KU “BEDËR”. (Evidenca nr. 23 Vendim i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore; Evidenca nr. 20 Udhëzim për ngarkesën mësimore)
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën	Referuar informacionit të përcjellë, GVJ konstaton se njësi bazë në fillim të vitit akademik angazhon një asistent pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës. Personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale dhe pedagogu që zhvillon këtë lëndë informon studentët për procedurat dhe mundësinë për përzgjedhje e institucioneve pranë të cilave do të zhvillohet kjo praktikë. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e gjithë procesit dhe mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës. Hapat procedurale që duhen ndjekur për zhvillimin e praktikës profesionale u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit të

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>dytë akademik.</p> <p>GVJ zhvilloi takime me stafin akademik dhe studentët të cilët ritheksuan procedurat e zhvillimit të praktikës profesionale dhe faktin që KU “BEDËR” u krijon atyre mundësinë për ta zhvilluar praktikën pranë institucioneve publike dhe private të sistemit të arsimit parauniversitar. Studentët pohuan se në disa raste ishin ata që kishin zgjedhur institucionin pranë të cilit do të zhvillonin praktikën. (Evidenca nr. 27 Procedurë e praktikës profesionale; Evidenca nr. 47 Vendimi i Këshillit të Departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës dhe koordinimin me zyrat e tjera)</p> <p>Temat e diplomave përcaktohen nga studentët dhe pedagogët udhëheqës dhe paraqiten para Këshillit Shkencor për shqyrtim dhe miratim. (Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë)</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se në vijim të ndjekjes dhe mbikqyrjes së procedurave të kryerjes së praktikës profesionale dhe monitorimit dhe vlerësimit të saj pranë departamentit përgjegjës dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës studentët kanë për detyrë të dorëzojnë formularët e plotësuar nga ata vetë, drejtuesit e institucionit pranë të cilit kanë kryer praktikën dhe lektori i lëndës. (Evidenca nr. 27 Procedurë e Praktikës Profesionale)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit nuk i përmbush plotësisht kriteret dhe detyrimet ligjore të përcaktuara në LA. Angazhimi i personelit akademik me kualifikimin “Masteri i Shkencave” në mësimdhënie për këtë program studimi bie ndesh me kuadrin ligjor. Për vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023 është angazhuar si PAE në mësimdhënie programin e studimit vetëm një (1) personel me titullin Profesor i Asociuar. PAE i angazhuar në programin e studimit e mbulon ngarkesën mësimore të zhvilluar në masën 100%. Personeli akademik është punësuar mbi bazën e të gjithë kriterëve dhe zotëron të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbështetur në legjislacionin në fuqi. Për rekrutimin e stafit akademik janë ndjekur të gjitha hapat e procedures. Në këtë program studimi nuk janë të programuara për t’u zhvilluar orë laboratorike, ndaj në</i></p>

	<i>strukturën mbështetëse nuk është vënë në dispozicion personel ndihmës akademik. Zyra e Burimeve Njerëzore siguron dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe administron dosjet personale. Personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës profesionale informon studentët për procedurat dhe mundësinë për përzgjedhje e institucioneve pranë të cilave do të zhvillohet kjo praktikë. Kjo strukturë është përgjegjëse për mbikqyrjen e gjithë procesit dhe mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	



Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Procesi mësimor për studentët e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët kryet pranë ambienteve të vëna në dispozicion nga KU BEDËR Bazuar tek materiali i vënë në dispozicion nga GVB dhe pas vizitave dhe vëzhgimeve të kryera në mjediset e institucionit, GVJ konstatoi se në përmbushje të nevojave dhe në funksion të procesit mësimor, studentët e këtij programi studimi shfrytëzojnë 5 auditorë leksionesh sikurse dhe një neësroom, një bibliotekë dhe një laborator kompjuterash. (Evidenca Aneks RVB tabela 16) Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, GVJ vizitoi mjediset e vëna në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të programit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizitës në mjediset e fakultetit dhe bashkëbisedimit me personelin akademik dhe studentët u vlerësua fakti se pajisjet elektronike dhe të teknologjisë më të avancuar së informacionit vihen në dispozicion të procesit mësimor. GVJ konstatoi se mjediset e shfrytëzuar për procesin e

<p>informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>mësimdhënies ishin të pajisur me tabela interaktive, videoprojektorë, kompjutera dhe kishin akses në internet.</p> <p>Gjatë takimit të realizuar nga GVJ, studentët pohuan se të gjitha pajisjet ishin aktive dhe të vëna në dispozicion të studentëve dhe i shërbenin në mënyrë efikase procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. (Evidenca Aneks RVB tabela 16)</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVV, GVJ vizitoi nga afër mjediset e KU BEDËR nga ku konstatoi se sallat e laboratorëve dhe auditorët e leksioneve janë të pajisura me mjetet e duhura për kryerjen e një procesi mësimor bashkëkohor dhe janë në funksion të përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Studentët pohuan gjatë takimeve me ta, se këto mundësi shfrytëzoheshin maksimalisht. (Evidenca Aneks RVB tabela 16, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi nga afër mjediset e KU BEDËR dhe laboratorët e kompjuterave dhe sallën multimediale të cilat siç u pohua edhe nga vetë anëtarët e stafit akademik, për shkak të specifikës dhe natyrës së programit të studimit, nuk shfrytëzoheshin maksimalisht nga studentët e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi “Gjuhë Angleze” me profile Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë dhe për Arsimin e Mesëm të Ulët. (Evidenca Aneks RVB tabela 16, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë</p>	<p>GVJ konstaton se për shkak të natyrës së programit të studimit, veçorive që ai ka dhe kushteve specifike që duhet të përmbushen, praktikat profesionale nuk zhvillohen në mjediset e institucionit.</p> <p>Për realizimin e praktikës profesionale, KU BEDËR ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit parauniversitar. GVJ shqyrtoi listën e këtyre institucioneve duke iu referuar të dhënave të vëna në dispozicion të tabelat shtojcë të RVB ndërkohë që konstatoi nga takimet në institucion nga personeli i stafit akademik dhe studentët që aktualisht po kryenin praktikën profesionale se për qëllime të veçanta IAL-ja kishte lidhur marrëveshje me strukturat përgjegjëse të arsimit parauniversitar për të lehtësuar procedurat e kryerjes së praktikës edhe në institucione publike, përveç atyre të përmendura në evidencat e paraqitura.</p>

strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.									
Konkluzione	<i>Në funksion të procesit mësimor, studentët e programit të studimit shfrytëzojnë mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, të tillë si: pesë auditorë leksionesh, një neësroom dhe një bibliotekë. Pajisjet elektronike dhe të teknologjisë më të avancuar të informacionit vihen në dispozicin të procesit mësimor. Mjediset e shfrytëzuar për procesin e mësimdhënies janë të pajisur me tabela interaktive, videoprojektorë, kompjutera dhe internet. Sallat e laboratorëve dhe auditorët e leksioneve janë të pajisura me mjetet e duhura për kryerjen e një procesi mësimor bashkëkohor. Për realizimin e praktikës profesionale, KU BEDËR ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit parauniversitar.</i>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion (programet lëndore) dhe nga bashkëbisedimi me pedagogët dhe studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se studentët dhe personeli akademik i këtij programi shfrytëzon burime literature fizike dhe digjitale dhe burimet e literaturës janë të përcaktuara në rubrikat e burimeve bazë të detyrueshme dhe të rekomanduara të syllbuseve të lëndëve përkatëse. (Evidenca Aneks RVB programet lëndore)
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Referuar takimeve me punonjësen e bibliotekës dhe drejtuesve të njësisë bazë dhe asaj kryesore u theksua fakti se pedagogët shprehin në mënyrë të vazhdueshme kërkesat për pasurimin e bibliotekës me literaturë të përditësuar. GVJ konstatoi se burimet e literaturës të përfshirë në syllabuset e lëndëve, sidomos literatura e detyruar, nuk është e gjitha e përditësuar me botime të dekadës së fundit si për shembull në rastin e lëndëve “Zhvillimi i Kurrikulës” (viti i botimit të literaturës 2003); “Metoda

	<p>Kërkimore”, (viti i botimit të literaturës 2013/2007); “Vlerësimi i të nxënit”, viti i botimit të literaturës 2004/2011, etj. (Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit).</p> <p>Pasi shqyrtoi programet lëndore dhe literaturën e rekomanduar për shfrytëzim dhe vëzhgoi nga afër fondin e burimeve fizike në bibliotekën e institucionit, GVJ konstaton se tekstet që u ishin rekomanduar studentëve për shfrytëzim nuk gjendeshin në fondin fizik të kësaj biblioteke. (Evidenca nr 19 Syllabuset e lëndëve; Aneks RVB Tabela 14 Modeli i syllabuseve; Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët dhe personeli akademik i këtij programi shfrytëzojnë 1 sallë biblioteke. (Evidenca nr. 57 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës).</p> <p>Në fondin fizik të bibliotekës mund të shfrytëzohen 22.600 tituj shkencor, 26.000 libra shkencorë, 166 monografi, dhe 48 revista shkencore. Mjediset e bibliotekës ofrojnë 24 poste studimi dhe në shërbim të studentëve janë vënë 8 kompjutera. (Evidenca Aneks RVB Tabela 17)</p> <p>Gjithashtu nga sa u parashtrua nga vizita në mjediset e bibliotekës dhe takimeve me studentë dhe staf akademik, si burime të shfrytëzueshme literature mund të përdoren edhe revista shkencore me akses të hapur sikurse dhe literaturë e ofruar nga platforma online JSTORE e cila siguron përdorimin pa limit dhe pa pagesë të më tepër se 12 milion artikujve të revistave shkencore, librave dhe burimeve parësore në 75 disiplina të ndryshme. (Evidenca nr. 44 Marrëveshja për akses në JSTORE; Evidenca Aneks RVB Tabela 17)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së</p>	<p>Pasi u njoh me të dhënat dhe informacionet e vëna në dispozicion përmes DVV, GVJ vizitoi nga afër mjediset funksionale të bibliotekës fizike të institucionit e cila ofron shërbim çdo ditë të javës dhe gjatë sezonit të provimeve edhe në fundjavë.</p> <p>Përveç fondit fizik, studentëve u jepej mundësia të shfrytëzonin edhe burimet online të ofruara kryesisht përmes JSTORE, platformës shkencore online e cila siguron akses për mëse 12 milion artikuj të revistave të ndryshme. (Evidenca nr. 57 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës; Evidenca nr. 44 Marrëveshja për akses në JSTORE; Evidenca Aneks RVB Tabela 17)</p>






programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë takimeve institucionale me përfaqësues të studentëve të programit të studimit, këta të fundit ritheksuan faktin se shërbimet e bibliotekave ishin efikase dhe burimet e ofruara ishin lehtësisht të aksesueshme prej tyre.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konstatoi pas vizitës në institucion se biblioteka ishte e pajisura me kompjuter, printera dhe fotokopje sikurse dhe me programe kompjuterike lehtësisht të aksesueshëm dhe të vënë në përdorim nga studentët. Studentët mund të aksesonin online një sërë materialesh sikurse dhe të gjithë database-n e bibliotekës e cila ishte vënë në dispozicion edhe online. (Evidenca nr. 57 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës; Vizita në institucion)
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë takimit në mjediset e bibliotekës, personeli përgjegjës theksoi edhe një herë orarin e funksionimit të bibliotekës (edhe gjatë fundjavës) dhe kapacitetin maksimal të shfrytëzimit. Gjithashtu gjatë vizitës u ritheksua fakti se studentët mund të bëjnë kërkesën e sigurimit e materialeve në mënyrë elektronikë falë një sistemi të automatizuar të vënë në dispozicion të bibliotekës nga KU BEDËR. Materialet elektronikisht sigurohen nga biblioteka online JSTOR e cila funksionon për studentët me një shërbim 24/7. (Evidenca nr. 57 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës; Vizita në institucion)
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin	Institucioni, në bashkëpunim me personelin akademik planifikon në mënyrë periodike shtimin e fondit të librave me tituj të rinj. Kërkesat për shtim të literaturës parashtrihen në fillim të çdo viti akademik dhe nga sa u referua nga takimet me drejtues të njësive dhe pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, institucioni ve në dispozicion një fond të veçantë financimi për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. (Evidenca nr. 57 Udhëzim për funksionimin e bibliotekës, Vizita në institucion)

fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<i>Studentët e këtij programi studimi shfrytëzojnë burime literature fizike dhe digjitale të përcaktuara në rubrikat e burimeve bazë të detyrueshme dhe të rekomanduara. Burimet e literaturës të përfshirë në syllabuset e lëndëve nuk janë të gjitha të përditësuara me botime të dekadës së fundit. Tekstet rekomanduar studentëve për shfrytëzim nuk gjenden në fondin fizik të kësaj biblioteke. Studentëve u jepet mundësia të shfrytëzojnë edhe burimet online të ofruara kryesisht përmes platformës shkencore JSTOR. Institucioni, në bashkëpunim me personelin akademik planifikon në mënyrë periodike shtimin e fondit të librave me tituj të rinj. Kërkesat për shtim të literaturës parashtrihen në fillim të çdo viti akademik dhe institucioni ve në dispozicion një fond të veçantë financimi për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Dokumentacioni i plotësuar nga GVV përcakton qartë se KU Beder ka aktivizuar një strukturë të teknologjisë së informacionit <i>bis.beder.edu.al (BIS)</i> të aksesueshëm nga studentët dhe pedagogët përmes së cilit bëhet i mundur komunikimi mes strukturave, mbledhja dhe administrimi i të dhënave, koordinimin e proceseve mësimore dhe administrative, shkëmbimin e informacionit me studentët, anketimet etj.</p> <p>Përmes këtij sistemi ruhen dhe mirëmbahen të dhënat për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve, ruhen informacione për ecurinë e tyre (frekuentimin, vlerësimin, numrin e ECTS të fituara, statusi kalues/jokalues etj.)</p> <p>(Evidenca nr. 37 Udhëzuesi i sistemit informativ(BIS); Evidencë Aneks RVB Tabela 17)</p>

<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Informacioni dhe dokumentacioni i veprimtarisë së personelit akademik, ndihmës akademik dhe i studentëve ruhet dhe administrohet nga sistemi i brendshëm i automatizuar BIS. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në DVB, GVJ konstatoi se të gjitha njësitë dhe strukturat në përbërjen organizative të KU Beder, sikurse dhe gjithë stafi akademik, studentët dhe sekretaritetë mësimore kanë llogari në sistemin BIS. Përmes këtij sistemi të automatizuar sigurohet edhe bashkërendimi dhe ndërveprimi midis të gjitha njësive. Gjithashtu në përdorim të stafit dhe studentëve është vënë edhe platforma online @beder.edu.al e cila u ofron të gjithë përdoruesve me llogari emaol@beder.edu.al mundësi të pakufizuar.</p> <p>(Evidencë nr. 37 Udhëzuesi i sistemit informativ(BIS))</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas të dhënave të paraqitura në DVV, sistemi BIS përmes moduleve të përcaktuara u jep studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ mundësinë për të aksesuar dokumentacionin e kërkuar, për të marrë të dhëna dhe informacionet e kërkuar.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sipas të dhënave të paraqitura në DVV, sistemi BIS përmes moduleve të përcaktuara u jep studentëve, stafit akademik, atij administrativ mundësinë për të aksesuar dokumentacionin e kërkuar, për të marrë të dhëna dhe informacionet e kërkuar. Përmes këtij sistemi referohen të dhëna për regjistrimin e studentëve në lëndë dhe module të ndryshme sipas semestrave përkatës dhe lehtësojë procedurat e regjistrimit.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV rezulton se sistemi i shkëmbimit të të dhënave midis sektorëve të ndryshëm është aktiv dhe ofron informacion për veprimtarinë akademike dhe administrative në kohë reale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ-së ju konfirmua nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët se sistemi i menaxhimit të informacionit në rang njësie kryesore dhe njësie bazë, u mundësonte të gjithë strukturave të përfshira komunikim të shpejtë, efikas dhe të përditësuar.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e</p>	<p>Pas verifikimeve të kryera, GVJ konstatoi se faqja e internetit të institucionit përmban informacion të zgjeruar, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm. Të dhënat e paraqitura në faqen e internetit (të ofruara në shqip edhe anglisht) u vijnë në ndihmë</p>

ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.

studentëve veçanarisht në lidhje me orarin mësimor, kalendarin akademik, të dhënat për bibliotekën apo për strukturat e ndryshme, njoftime për punë, për zhvillimin e praktikave profesionale, rezultatet e anketave të zhvilluara etj.

Studentët e këtij programi studimi, gjatë takimeve me GVJ, rikonfirmuan faktin se faqja e internetit shfrytëzohej maksimalisht prej tyre dhe se informacioni i përcjellë ishte i plotë, i nevojshëm dhe i përditësuar në kohë reale. **(Evidencë edueng. Beder.edu.al; vizita në institucion)**

Konkluzione

Sistemi i informacionit bis.beder.edu.al (BIS) mundëson komunikimin mes strukturave, koordinimin e proceseve mësimore dhe administrative dhe shkëmbimin e informacionit me studentët. Ky sistem ruan dhe mirëmban të dhënat për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Të gjitha njësitë dhe strukturat e institucionit, stafi akademik, studentët dhe sekretaritë mësimore kanë llogari në sistemin BIS. Përmes këtij sistemi të automatizuar sigurohet edhe bashkërendimi dhe ndërvëprimi midis të gjitha njësive. Platforma online @beder.edu.al u ofron të gjithë përdoruesve me llogari email@beder.edu.al mundësi të pakufizuar. Faqja e internetit të institucionit përmban informacion të zgjeruar, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.5
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumentacionit të paraqitur në DVV, në fillim të çdo viti akademik, fondacioni Hafiz Ali Korça, harton dhe paraqet raportin vjetor në të cilin përfshihet analiza e të ardhurave, shpenzimeve dhe realizimit të buxhetit financiar. KU Beder është një institucion arsimor i lartë jofitimprurës dhe si i tillë të ardhurat kryesore sigurohen përmes donacioneve. Në kuadër të ndarjes së të ardhurave të përcaktuara për njësinë bazë, Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës Angleze, ky i fundit harton në fillim të çdo viti akademik një plan buxhet për mbështetjen

	<p>financiare të parashikuar në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë akademike të kësaj njësie. Në këtë plan buxhet parashikohen shpenzimet e përllogaritura për kërkimin shkencor (Research and Development) dhe konkretisht për botime shkencore, trajnime të stafit, pjesëmarrje në konferenca dhe seminare, shpenzime për konferenca, për pjesëmarrje në konferenca, shpenzime promovimi, shpenzime në mbështetje të studentëve, shpenzime për literaturën e re. (Evidencë nr. 77 Projekt buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze)</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Referuar DVV, projekt buxheti i njësisë bazë merr përsipër parashikimin e të ardhurave, kostove të shpenzimeve të përllogaritura që lidhen kryesisht me pagesat për burimet njerëzore, përmirësimin e pajisjeve, sigurimin e bazës materiale mirëmbajtje mjedisi dhe infrastrukture, shpenzime për literaturën e përditësuar në varësi të nevojave për përditësim që paraqesin anëtarët e personelit akademik etj. (Evidencë nr. 77 Projekt buxheti i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze; Evidencë Aneks RVB, Tabela 18)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se auditimi i brendshëm periodik i gjendjes financiare kryhet nga një person i autorizuar i caktuar nga Fondacioni Hafiz Ali Korça, i cili siguron mbështetjen financiare të kësaj IAL-je. Pranë fondacionit ruhet edhe dokumentacioni përkatës për institucionin i cili hartohet bazuar në Ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (Ref .4.14 Miratimi i Buxhetit 2022)</p> <p>Bashkëngjitur me dokumentacionin e paraqitur në DVV, është</p>




	<p>përfshirë analiza e realizimit të buxhetit financiar dhe detajimi i planit të buxhetit financiar të hartuar për vitin 2022.</p> <p>Raporti i detajuar certifikohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të Universitetit dhe kontrollon nga Ministria e Financave, bazuar në LAL 80/2015, neni 116, pika 2. (Ref. 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Pasqyra financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve hartohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe raportohet periodikisht nga institucioni pranë MAS. Bashkëngjitur me dokumentacionin e paraqitur në DVV, si pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë Ministrisë së Arsimit përfshihet edhe analiza e realizimit të buxhetit financiar dhe detajimi i planit të buxhetit financiar për vitin pasardhës dhe projekt buxheti afat mesëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të përcjellë përmes DVV, GVJ konstatoi se KU “BEDËR” është një institucion i lartë arsimor jofitimprurës dhe të ardhurat e tij sigurohen kryesisht përmes donacioneve.</p> <p>Qëndrueshmëria e vazhdueshme financiare që ky institucion ka reflektuar dëshmon për një mbështetje financiare të plotë dhe për burime dhe kapacitete të siguruara.</p> <p>Programi financiar i hartuar nga KU “BEDËR” prej nga sigurohet shpërndarja e burimeve mbështetjet në standardet kombëtare për hartimin dhe raportimin financiar dhe përputhet me bazën ligjore të përcaktuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH” dhe ligjin 87/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Fondacioni Hafiz Ali Korça, harton dhe paraqet raportin vjetor të buxhetit financiar. KU “BEDËR” i siguron të ardhurat kryesore përmes donacioneve. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, harton në fillim të çdo viti akademik një plan buxhet për mbështetjen financiare të parashikuar në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë akademike të kësaj njësie ku paparshikohen shpenzimet e përlllogaritura për kërkimin shkencor, pagesat për burimet njerëzore, përmirësimin e pajisjeve, sigurimin e bazës materiale, shpenzimet për literaturën etj Auditimi i brendshëm periodik i gjendjes financiare kryhet nga Fondacioni Hafiz Ali Korça, i cili siguron mbështetjen</i></p>


	<i>financiare të kësaj IAL-je.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur për shqyrtim nga GVB, GVJ konstaton se hartimi i programeve të studimit të ciklit të dytë, ku përfshihet edhe programi Master Profesional Mësuesi në “Gjuhë Angleze” kryhet në përputhje dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr.80/2015 si dhe me aktet rregullatore në fuqi. (Evidencë nr. 13 Praktika e ndjekur për miratimin e kritereve të pranimit të studentëve)</p> <p>Strukturat përgjegjëse institucionale bashkërendojnë marrëdhëniet me studentët që nga momenti i regjistrimit të tyre e deri në diplomim. Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e kësaj zyre mbështeten në rregulloren themelore të IAL-së dhe rregulloren e programit të studimit. (Rregullorja e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Gjuhë Angleze: Evidenca nr. 5 Rregullorja themelore e KU Beder).</p> <p>Në kreun 10 të rregullores themelore të KU Beder, përcaktohen kriteret e pranimit, regjistrimit dhe transferimit të studentëve. Gjithashtu po në këtë rregullore përcaktohen kriteret e veçanta për regjistrimin e studentëve me aftësi ndryshe, njohja e gjuhës së huaj, procedurat që duhen ndjekur në rastin e ngrirjes së studimeve, transferimit të studimeve, njohja e krediteve nga universitete të tjera. Studentët janë të pajisur me kartën e studentit. Marrëdhënia me studentët dhe plotësimi i kërkesave</p>

	<p>dhe nevojave të studentëve kryhet edhe përmes raporteve të drejtpërdrejta të vendosura midis tyre dhe pedagogëve. (Rregullorja e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Gjuhë Angleze; Evidenca nr. 5 Rregullorja themelore e KU BEDËR)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pranimi i studentëve në programin e studimit Master Profesional kryhet sipas procedurave dhe kriterëve të bazuara në legjislacionin në fuqi duke garantuar barazi gjinore dhe fetare dhe të drejta të barabarta për të gjithë kandidatët për student. Bazuar tek dokumentacioni i paraqitur, kriteret e pranimit përcaktohen nga institucioni dhe bëhen të njohura në faqen zyrtare. Ndërkohë që kriteret e përcaktuara për kalimin e studentëve nga një vit akademik tek tjetri përcaktohen në rregulloren themelore të institucionit, dhe rregulloren e programit të studimit (Rregullorja e programit të studimit Master Profesional Mësuesi në Gjuhë Angleze; Evidenca nr. 5 Rregullorja themelore e KU Beder)</p> <p>Institucioni siguron kushte të posaçme për studentët me aftësi të ndryshe sikurse dhe trajton me mbështetje financiare deri në masën 100% studentë të talentuar dhe me merita të veçanta. [www.beder.edu.al]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Dokumentacioni mbështetës i vënë në dispozicion për GVJ, sqaron mënyrën e përcaktimit të kriterëve së përzgjedhjes së kandidatëve mbështetur në aktet e nxjerra nga MASR si dhe kriteret e veçanta të hartuara dhe të propozuar nga njësia bazë.</p> <p>Kriteret e përcaktuara, publikohen në Eëbsite zyrtar dhe në sesionet e promovimit të programit të studimit, ku një nga to është edhe panairi Work and Study. (Evidencë nr. 85 Pjesëmarrja në panairin Work and Study)</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur nga GVB përcakton qartë se përmbajtja e programeve të studimit Master, të dhënat bazë mbi kurrikulën, personelin akademik dhe strukturat organizative, sikurse dhe kriteret e miratuara për rregjistrim, transferime dhe njohje të studimeve bëhen publike përmes shpalljes në faqen zyrtare të KU BEDËR dhenë të gjitha faqet eeb të fakulteteve dhe departamenteve [www.beder.edu.al]</p> <p>Studentëve marrin informacion të vazhdueshëm edhe pranë</p>


lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	zyrave të sekretarive e konkretisht; sekretarisë mësimore, sekretarive të departamenteve apo zyrës së pranimit.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Bazuar tek informacioni i paraqitur në DVV dhe i konfirmuar nga vizita në institucion, KU BEDËR, përmes faqes ëeb, informon të interesuarit në lidhje me kriteret e përcaktuara për aplikimet në të gjitha programet e studimit që ky institucion ofron. Institucioni jep informacione të detajuara për të interesuarit në panaiet e organizuara me qëllim informimin dhe promovimin e programit të studimit. IAL-ja organizon edhe takime të veçanta në mjediset e institucionit, ku të gjithë të interesuarit kanë mundësi të vizitojnë mjediset, infrastrukturën, laboratorët, bibliotekën dhe të gjitha shërbimet që ky institucion ofron (Evidenca nr. 86 Open Day pranë ambienteve të KU BEDËR) Në takimin e zhvilluar me GVJ, studentët pohuan se kishin marrë informacion të plotë dhe të detajuar pikërisht përmes mjeteve të informimit të sipërpërmendura
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Dokumentacioni i përcjellë përmes DVV, përcakton qartë se përzgjedhja e kriterëve të pranimit për persona me status të veçantë, mbështetet në bazën ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi dhe në rregulloren e institucionit arsimor. Në fillim të vitit akademik bëhen të ditura kriteret e përcaktuara për rregjistrimin e personave përfitues për shkak të statusit të veçantë, studentët me nevoja specifike dhe ata që u përkasin shtresave të marginalizuara. Studentët që u përkasin këtyre kategorive trajtohen me bursë të veçantë. (Evidenca nr. 46 Praktikat e ndjekura për miratimin e kuotave për rregjistrimin e studentëve; Evidenca nr. 13 Praktikat e ndjekura për miratimin e kuotave për rregjistrimin e studentëve) KU BEDËR mbështet me bursa ekselence, talenti dhe përkrahjeje sociale shtresat grupet dhe kategoritë në nevojë. Miratimi i bursave bëhet në përputhje me rregulloren e hartuar për përjashtimin nga tarifat e studimit kategoritë e përmendura më lart. (Evidencë nr. 70 Rregullorja për zbritjen nga tarifat e studimit)
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Të njëjtat procedura, të bazuara në të njëjtën bazë ligjore ndiqen edhe për hartimin dhe miratimin e kriterëve për kandidatët që vijnë nga trojet shqiptare. Gjatë vizitave në institucion dhe takimeve me organet drejtuese të fakultetit u theksua fakti se pranë KU BEDËR dhe më konkretisht në Departamentin e


	Edukimit dhe Gjuhës Angleze ishin rregjistruar edhe studentë të huaj. (Evidenca nr. 46 Praktikat e ndjekura për miratimin e kuotave për rregjistrimin e studentëve; Evidenca nr. 13 Praktikat e ndjekura për miratimin e kuotave për rregjistrimin e studentëve)			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstaton se politikat e ndihmës financiare të ofruar nga institucioni, në mbështetje të kategorive në nevojë, bëhen të ditura në çdo fillim viti akademik dhe mbështeten në procedurat e hartuar për këtë qëllim.(Evidencë nr. 46 Praktikat e ndjekura për miratimin e kuotave për rregjistrimin e studentëve)			
Konkluzione	<i>Hartimi i programit të studimit është kryer në përputhje dhe procedurat e parashikuara ligjore. Strukturat institucionale sigurojnë marrëdhëniet me studentët që nga momenti i rregjistrimit të tyre e deri në diplomim. Kriteret e pranimit në këtë program përcaktohen nga institucioni dhe bëhen të njohura në faqen zyrtare. Përmbajtja e programit të studimit, kriteret e miratuara për rregjistrim, transferime dhe njohje të studimeve bëhen publike përmes shpalljes në faqen zyrtare të institucionit dhe në faqet eeb të fakulteteve dhe departamenteve. Përzgjedhja e kriterëve të pranimit për persona me status të veçantë, mbështetet në bazën ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. KU Beder mbështet studentët me bursa ekselence, talenti dhe përkrahjeje sociale. Miratimi i bursave bëhet në përputhje me rregulloren e hartuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të	Bazuar tek dokumentacioni i paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë u konstatua se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve dhe

<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>aftësive të studentëve sikundër dhe përparimit të tyre nga një vit akademik tek tjetri. I gjithë informacioni është i përfshirë në guidën e studentit. (Evidenca nr 43 Guida e studentit) Po kështu, gjatë takimeve në institucion u konfirmua se të drejtën për dhënie informacioni e ka sekretaria mësimore dhe sekretaria e departamentit Për këtë qëllim është vënë në dispozicion edhe faqja WEB e institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës, GVJ konstatoi se të gjitha procedurat e kryera në kuadër të informimit të studentëve mbi njohje e krediteve për njohuri të fituara më parë më parë kualifikimet e mëparshme apo studimet e pjesëshme, kryhen në përputhje me rregulloren e programit të studimit, përkatësisht në nenin 9 të saj. Kushtet dhe kriteret e transferimit janë përcaktuar në nenin 12 të rregullores së programit të studimit. (Evidenca nr 7 Rregullore e programit të studimit Master në Mësuesi në Gjuhë Angleze) Bazuar te kjo rregullore studentët që u janë nënshtruar procedurave për ekuivalentim, u nevojiten që të kenë zhvilluar mësim me jo më pak se dy semestra pranë KU BEDËR, në mënyrë që të marrin diplomën e këtij institucioni. (Evidenca nr 7 Rregullore e programit të studimit Master në Mësuesi në Gjuhë Angleze) Rregullorja e transferimit të studimeve është një tjetër dokument i hartuar nga struktura përgjegjëse për programin e studimit Master në Mësuesi në të cilën përcaktohen në mënyrë të detajuar kriteret e aplikimit për transferim të studimeve, transferimet horizontale, njohja e krediteve të programeve universitare të certifikuara, kriteret për transferim etj. (Evidencë nr.25 Rregullorja për transferim të studimeve)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur nga GVB dhe takimet e zhvilluara në institucion me anëtarë të stafit akademik dhe studentë, u pohua se informimi i studentëve mbi planin mësimor, përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që zhvillohen, vlerësimet e marra nga provimet e ndërmjetme, seminareve, detyrave të kursit, projekteve, prezantimeve dhe provimit përfundimtar bëhet përmes faqes zyrtare të institucionit sikurse dhe përmes takimeve që titullarët e lëndëve zhvillojnë me studentët. Sistemi BIS përdoret gjithashtu si platformë për informimin e studentëve mbi frekuentimin, rezultatet e marra gjatë semestrit dhe mesataren e arritur në fund të vitit.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i paraqitur në DVV (rregullorja e programit dhe rregullorja e ciklit të dytë të provimeve) GVJ konstatoi se përmbyllja e detyrimeve të programit të studimit të ciklit të dytë kryhet me punim diplome dhe se kriteret dhe procedurat e diplomimit u bëhen të ditura studentëve që në javën e parë të fillimit të studimeve. Gjatë takimit të realizuar në institucion me grupin e studentëve, GVJ vëren se në dispozicion të aftësisimit sa më të plotë të studentëve për hartimin e temës së diplomës, pjesë e kurrikulës janë bërë edhe lëndë si “Metoda kërkimore” dhe “Teza”. Gjithashtu studentët vlerësonin si të domosdoshme dhe të vlefshme seancat e konsultimit që zhvillojnë me pedagogët udhëheqës të temës. (Evidencë nr. 27 Rregullore e programit të studimit Master në Mësuesi në Gjuhë Angleze; Takimet në institucion)</p> <p>GVJ konstaton se në nenin 40 të rregullores së studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë bashkërenduesi i programit të studimit i propozon Dekanatit pedagogun udhëheqës të tezës dhe temën e përcaktuar të diplomës. GVJ rekomandon se studentit mund ti njihet e drejta për të zgjedhur vetë temën e diplomës duke u mbështetur tek disa alternativa që parashtron procedura e rregjistrimit. (Evidencë nr. 4 Rregullore e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë)</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Njësia bazë, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze promovon programet e ciklit të dytë të ofruara nga ky department në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me Drejtoritë Arsimore Rajonale. Fushatat informuese realizohen kryesisht përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve, katalogëve, takimeve informuese me maurantë, pjesëmarrjes në panairë dhe faqes ËEB. Për këtë qëllim pranë institucionit realizohen edhe takimet me studentë të interesuar për këtë program studimi gjatë të ashtuquajturave Open Days. (Evidencë nr.85 Pjesëmarrja në panairin Ëork and Study; Evidencë nr. 86 Open Day pranë ambienteve të KU BEDËR ; Evidencë nr.68 Programi i ditëve të orientimit)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia bazë ve në dispozicion informacion të plotë në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve, aftësive të studentëve dhe përparimit të tyre. Të gjitha procedurat e informimit të studentëve kryhen në përputhje me rregulloren e programit të studimit. Kriteret e aplikimit për transferim të studimeve dhe njohja e krediteve të programeve univeritare të certifikuara, janë të përcaktuara në Rregullore. Informimi i studentëve bëhet përmes</i></p>




	<i>faqes zyrtare dhe takimeve me titullarët e lëndëve. Përmbyllja e detyrimeve kryhet me punim diplome. Njësa bazë promovon programet në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me Drejtoritë Arsimore Rajonale. Fushatat informuese realizohen kryesisht përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve, katalogëve, takimeve informuese me maurantë, pjesëmarrjes në panairë dhe faqes WEB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Pas shqyrtimit të materialit mbështetës të vënë në dispozicion dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në fillim të çdo viti akademik titullarët e njësisë bazë, asaj kryesore dhe anëtarët e personelit akademik i informojnë studentët mbi strukturën, organizimin, kurrikulat, rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit (Evidencë Vizita e insitucion).</p> <p>Përveç dhënies së informacionit të marrë përmes takimeve, përgjegjës për kontaktet e vazhdueshme me studentët gjatë gjithë procesit të studimit është Këshilltari Akademik. Detyrat e dhe përgjegjësitë e këshilltarit akademik përcaktohen në Udhëzuesin e Këshilltarit Akademik dhe kryesisht lidhen me orientimin që u bën studentëve për përzgjedhjen e lëndëve, informimin në lidhje me kalimin e lëndëve të nivelit parauniversitar dhe universitar, rregulloren e provimeve, informon studentët në lidhje me programet e shkëmbimit, këshillon studentët në lidhje me kërkesat bazë akademike etj. (Evidencë nr 47 Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e Këshilltarit Akademik; Evidncë nr. 49 Udhëzuesi i këshilltarit akademik)</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Gjatë takimeve të GVJ të zhvilluara në institucion, studentët pohuan se merrnin informacion dhe udhëzoheshin në mënyrë të detajuar dhe të vazhdueshme mbi lëndët, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Studentët ishin njohur me rregulloren e programit, syllabuse, laboratorët, infrastrukturën mbështetëse,

<p>përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>sistemin BIS, dhe shërbimet e ofruara nga strukturat ndihmësakadematike. Shpërndarja e informacionit përveçse bëhet nga pedagogët në auditor, realizohet edhe përmes faqes EEB, zyrove të sekretarive dhe Guidës së Studentit. (Evidencë nr.43 Guida e studentit) Studentët kanë llogaritë e tyre në sistemin elektronik BIS, të cilin mund ta aksesojnë përmes adresave personale të tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin bazë të paraqitur, takimet me studentët dhe përfaqësues të strukturave përgjegjëse në fakultet, GVJ konstaton se zyra për Këshillimin e Karrierës, strukturë në varësinë e Dekanatit të studentëve, orienton dhe informon studentët drejt tregut të punës dhe mundësive për zhvillimin e karrierës. Çdo departament cakton nga një përfaqësues të vetin për të kryer funksionin e këshilltarit akademik pranë Zyrës së Karrierës. Një nga detyrat e kryera nga ky person përgjegjës është edhe dhënia e informacionit të nevojshëm mbi institucionet pranë të cilëve do të zhvillohet praktika profesionale apo dhe aplikimet për intershipe dhe pozicione të tjera pune. (Evidenca nr. 60 Raporti i Zyrës së Karrierës)</p> <p>Një tjetër strukturë institucionale është edhe Zyra e të diplomuarve, e cila mban kontakte me ish të diplomuarit. Programi Master profesional në Mësuesi, aktualisht në process akreditimi, i ristrukturuar në vitin 2021 nuk ka nxjerrë ende brezin e parë të të diplomuarve, kështu që në raportin e zyrës së të diplomuarve të paraqitur në DVV, mungojnë të dhënat për këtë program studimi. (Evidenca nr 59 Raporti i zyrës së të diplomuarve)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme mbi veprimtarinë mësimore, logjistikën dhe infrastrukturën e ngritur në mbështetjen e saj, sistemin e autorizuar dhe shërbimet e tjera të ofruara. Nga takimet e zhvilluara me studentët u konfirmua se përgjegjësi i njësisë bazë, sekretaria mësimore dhe personeli akademik u japin atyre informacion në mënyrë të vazhdueshme. Si mjete për shkëmbimin e informacionit, studentët shfrytëzojnë linkun (tt.beder.edu.al) dhe emailët e tyre personale</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara me studentët dhe personelin e sekretarisë mësimore, u konfirmua se institucioni ka vënë në përdorim një sistem informativ elektronik. Në fillim të vitit akademik studentët pajisen me një llogari institucionale të tyre. Edhe stafi akademik ka në përdorim adresa elektronike të</p>

dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	institucionit. Sistemi elektronik BIS mund të shfrytëzohet në kohë reale dhe informacioni ndahet në mënyrë të njëjtë tek të gjithë personat e interesuar. Si burime të tjera të shkëmbimit shërbejnë edhe faqja zyrtare dhe të gjitha mediat sociale të vëna në dispozicion.			
Konkluzione	<i>Studentët informohen në fillim të çdo viti akademik mbi strukturën, organizmin, kurrikulat, rregulloren e programit të studimit, formën e studimit, kreditet, ngarkesën në auditor, frekuentimin dhe format e vlerësimit. Studentët njihen me rregulloren e programit, syllabuset, laboratorët, infrastrukturën mbështetëse, sistemin BIS, dhe shërbimet e ofruara nga strukturat ndihmësakademike. Shpërndarja e informacionit bëhet nga pedagogët në auditor, përmes faqes EEB, zyrave të sekretarive dhe Guidës së Studentit. Zyra për Këshillimin e Karrierës, orienton dhe informon studentët drejt tregut të punës dhe mundësive për zhvillimin e karrierës. Çdo departament cakton nga një përfaqësues të vetin për të kryer funksionin e këshilltarit akademik pranë Zyrës së Karrierës. Zyra e të diplomuarve mban kontakte me ish të diplomuarit. Sistemi informativ elektronik shërben si mjet komunikimi. Studentët dhe stafi akademik ka në përdorim adresa elektronike të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstaton se IAL, Kolegji Universitar Beder, siguron, depoziton dhe ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të procesit mësimor. GVJ verifikoi nga afër dosjet personale të studentit regjistrin themeltar dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. Sekretaria mësimore ruan statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar për çdo program studimi. GVJ shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore ku verifikoi se këto të dhëna janë të dokumentuara në regjistrin themeltar të studentëve dhe regjistrin e lëshimit të diplomave. Zyra e të Diplomuarve zotëron një databazë me të dhënat mbi të



	gjithë studentët e diplomuar ndër vite dhe siguron kontaktet dhe bashkëpunimin me këtë kategori. (Evidencë nr. 69 Raport i zyrës së të diplomuarve)																						
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se sekretaria mësimore e KU Beder ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë si dhe tërheqet dhe largimet nga këto programe studimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se në programin e studimit Master Profesional në: Mësuesi në “Gjuhën Angleze” me profile mësues në AML dhe AMU numri i studentëve të regjistruar në dy vite akademike është si më poshtë vijojn: (Evidencë Aneks RVB Tabela 21)</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Profili</th> <th>Nr studentëve të regjistruar</th> <th>Nota mesatare ne hyrje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">2021-2022</td> <td>Mësues për arsimin e mesëm të lartë</td> <td>9</td> <td>7.77</td> </tr> <tr> <td>Mësues për arsimin e mesëm të ulët</td> <td>4</td> <td>7.28</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2022-2023</td> <td>Mësues për arsimin e mesëm të lartë</td> <td>16</td> <td>6.987</td> </tr> <tr> <td>Mësues për arsimin e mesëm të ulët</td> <td>2</td> <td>7.04</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Totali për të dy profilet</td> <td>31</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ shqyrtoi gjatë vizitës në institucion edhe dosjen e studentit e cila përmban informacione të veçanta për çdo të regjistruar që nga fillimi i ciklit e deri në përfundim të tij. Informacionet e ruajtura në hard copy janë të aksesueshme edhe përmes sistemit elektronik BIS. (Evidencë nr. 16 Raporti vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2021-2022; Evidencë nr. 26 Rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore)</p>	Viti akademik	Profili	Nr studentëve të regjistruar	Nota mesatare ne hyrje	2021-2022	Mësues për arsimin e mesëm të lartë	9	7.77	Mësues për arsimin e mesëm të ulët	4	7.28	2022-2023	Mësues për arsimin e mesëm të lartë	16	6.987	Mësues për arsimin e mesëm të ulët	2	7.04	Totali për të dy profilet		31	
Viti akademik	Profili	Nr studentëve të regjistruar	Nota mesatare ne hyrje																				
2021-2022	Mësues për arsimin e mesëm të lartë	9	7.77																				
	Mësues për arsimin e mesëm të ulët	4	7.28																				
2022-2023	Mësues për arsimin e mesëm të lartë	16	6.987																				
	Mësues për arsimin e mesëm të ulët	2	7.04																				
Totali për të dy profilet		31																					
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes	GVJ konstatoi se sekretaria mësimore ruan në formë elektronike dhe të shkruar të dhënat statistikore. Gjithashtu të dhënat ruhen në																						

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>të dyja format edhe nga njësi bazë edhe këshilltari akademik.</p> <p>Të gjitha të dhënat janë konfidenciale dhe mbrohen sipas legjislacionit të fuqi. (Evidencë nr. 49 Udhëzuesi i këshilltarit akademik; Evidencë nr. 35 Udhëzues i sistemit informativ BIS)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Referuar takimeve me drejtues së njësisë bazë dhe vëzhgimit në terren të punës strukturave ndihmës mësimore, GJV konstatoi se sekretaritë mësimore dhe strukturat e menaxhimit të brendshëm të informacionit, monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht nga institucioni me qëllim përmirësimin e punës dhe funksionimit të tyre (Evidencë nr. 26 Rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore; Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GJV konstaton se njësi bazë, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, harton raportin periodik ku përmblihen të gjitha të dhënat mbi ecurinë e studentëve përgjatë gjithë ciklit të tyre të studimit. Analiza SWOT, pjesë përbërëse e analizës së të dhënave synon reflektimin mbi nevojat për përmirësim që kjo strukturë duhet të marrë parasysh. (Evidencë nr. 16 Raporti vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, viti akademik 2021-2022)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron, depoziton dhe ruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të procesit mësimor. Sekretaria mësimore ruan statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar. Zyra e të Diplomuarve zotëron një databazë me të dhënat mbi të gjithë studentët e diplomuar dhe kontaktet me ta. KU Beder ruan dhe dokumenton statistika vjetore për numrin e studentëve të rregjistruar në programet e ciklit të dytë si dhe tërheqjet dhe largimet nga këto programe studimi. Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze, harton raportin periodik ku përmblihen të gjitha të dhënat mbi ecurinë e studentëve përgjatë gjithë ciklit të tyre të studimit përmes analizës SWOT.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmirësim	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU BEDËR dhe të gjitha strukturat përbërëse të tij sigurojnë përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. (Evidencë nr. 39 Vendim i Senatit për përfshirjen e studentëve në Këshillin e Departamentit dhe Këshillat e Fakultetit)</p> <p>Studentët gëzojnë të drejtën e vendimarrjes bazuar në LAL, nr.80/2015, neni 99.</p> <p>Një strukturë shumë e rëndësishme që siguron pjesëmarrjen e plotë dhe aktive të studentëve është edhe Dekanati i Studentëve, e cila siguron bashkërendimin e funksioneve të njëjësive brenda institucionit, koordinon dhe mbikqyr zhvillimin e praktikës profesionale dhe vlerëson mundësitë e ofruara në tregun e punës. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion me studentët dhe personin përgjegjës për koordinimin e detyrave dhe funksioneve të Dekanatit të studentëve, GVJ konstatoi se studentët kishin informacion të plotë mbi të drejtën e përfaqësimit në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Gjatë takimit me GVJ ata theksuan se struktura e Dekanatit të studentëve, siguronte zhvillimin e veprimtarive me karakter social, kulturor dhe argëtues. Studentët e pranishëm merrnin pjesë në disa Klube Studentore, veprimtaria e të cilëve inkurajonte talentet, aftësitë dhe pasionet e tyre. (Evidencë nr. 79 Lista e klubeve)</p> <p>Pjesë e strukturave është edhe Këshilli Studentor, i përbërë nga senatorët e përzgjedhur çdo vit nga studentët. (Evidenca nr. 58 Të dhënat e Këshillit Studentor)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo</p>	<p>Gjatë takimeve që studentët zhvilluan me GVJ, ata konfirmuan faktin se përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e këshillit të fakultetit dhe të departamentit dhe të grupeve të punës të ngritura në kuadër të procesit të akreditimit, Studentët u shprehën se stafi akademik</p>



<p>vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>dhe ai mbështetës inkurajojnë angazhimin e tyre në të gjitha veprimtaritë e organizuara.</p> <p>KU BEDËR siguron të drejtën e studentëve për të shprehur lirisht mendimin dhe gjykimin në anketat e vlerësimit të studentëve ndaj stafit akademik. (Evidenca nr. 30 Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve)</p> <p>Vlerësim për procesin mësimor dhe performancën e stafit akademik, infrastukturën etj. kryhet pas përfundimit të çdo semestri</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe zhvilloi takime me përfaqësues të studentëve GVJ konstatoi se në kuadër të vlerësimit të brendshëm, institucioni realizon anketa të vazhdueshme për matjen e cilësisë në strukturat akademike dhe ato administrative.</p> <p>Mbi bazën e anketimeve të zhvilluara njësa bazë dhe ajo kryesore harton raportin përfundimtar që e dërgon për shyrtim në rektorat. Nga biseda e zhvilluar me grupin e studentëve ata u shprehën se në mënyrë të vazhdueshme institucioni merr parasysh mendimet dhe sygjerimet e tyre për ndërhyrje në kurrikula apo për riorganizime të programeve të studimit. Studentët ishin angazhuar në mënyrë aktive edhe në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ kreu me studentët, ata u shprehën se ndiheshin të përfshirë dhe të angazhuar në proceset vendimarrëse të departamentit dhe se vlerësimi i mendimeve të tyre bëhej objektivisht, duke ju siguruar atyre barazi dhe paanshmëri</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Kuadri rregullator i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, përgjegjës për programin e studimit në process akreditimi u siguron studentëve mundësinë barazi dhe transparencën e procesin e vlerësimit dhe u siguron të drejtën për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve, si dhe të drejtën për të kërkuar rishikim apo rivlerësim.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ realizoi me grupin e studentëve, ata u shprehën se ishin të informuar me mundësinë e ankimimit të vlerësimit. Studentët mund të dërgojnë kërkesën për ankimim pranë sekretarisë së Departamentit dhe të marrin përgjigjen e cila është konfidenciale. (Evidencë nr 88. Procedura për anikimin e notes)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU Beder siguron përfshirjen e studentëve në organet</i></p>

	<p><i>vendimarrëse dhe këshilluese. Studentët kanë informacion të plotë mbi të drejtën e përfaqësimit. Dekanati i studentëve, siguron zhvillimin e veprimtarive me karakter social, kulturor dhe argëtues. Përfaqësuesit e tyre marrin pjesë në mbledhjet e këshillit të fakultetit dhe të departamentit dhe marrin pjesë në grupet e punës. Institucioni siguron të drejtën e studentëve për të shprehur lirisht mendimin dhe gjykimin në anketat e vlerësimit. Kuadri rregullator i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, u siguron studentëve mundësi të barabarta, transparencë në procesin e vlerësimit si dhe të drejtën për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të kontrollit të dijeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.6	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se në kuadër të njohjes të të drejtës për informim dhe transparencë, njësia kryesore dhe ajo bazë bën publike të dhënat mbi përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në Mësuesi. Faqja e internetit shërben si burim i hapur informacioni, ndërkohë që Guida e Studentit u bëhet e njohur studentëve në momentin që ata fillojnë studimet pranë këtij institucioni dhe përmban informacione në lidhje me shërbimet që i ofrohen studentit, mjetet e komunikimit me institucionin, rregullat akademike, tarifat e studimit, shkeljet e rregulloreve etj. (Evidencë nr 43 Guida e studentit)</p> <p>Të gjitha strukturat administrative vihen në funksion të informimit, krijimit dhe ruajtjes së kontakteve ne studentët. Zyra e Sekretarisë Mësimore, Zyra e Planifikimit të Karrierës, Zyra e Rregjistrimeve, Zyra e të Diplomuarve, Sekretaritet e Departamenteve dhe Këshilluesi Akademik janë disa nga strukturat institucionale që janë në dispzicion të informimit të studentëve.</p> <p>Përveç tyre edhe sistemi i automatizuar BIS përdoret si instrument për transmetimin e të dhënave që lidhen me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka</p>	<p>GVJ shqyrtoi dokumentacionin e bashkëngjitur në DVV lidhur me</p>

<p>ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të ngarkuara ndaj përfaqësuesve të dy strukturave të ngritura me qëllim mbikqyrjen e veprimtarisë së procesit mësimor, ndihmesën e dhënë në bashkërendimin e detyrave të kryera nga njësitë përkatëse dhe informimin e studentëve; përkatësisht Këshilluesi akademik dhe Këshilluesi i Karrierës.</p> <p>Nga sa vërehet në materialet e vëna në dispozicion të GVJ, Këshilluesi Akademik luan një rol kyç në mbarëvajtjen e komunikimit me studentët dhe mbikqyrjen e procesit mësimor përgjatë gjithë ciklit të studimit. Ndërsa detyrat e Këshilluesit të Karrierës lidhen kryesisht me informimin e studentëve për konferenca, trajnime, leksione të hapura, trajnime, praktikën profesionale, mundësi punësimi etj. (Evidencë nr. 47 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilluesit të Karrierës; Evidencë nr.49 Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar tek informacioni i dhënë përmes DVV, një rol mbështetës për studentët që kryejnë praktikën profesionale luan edhe Zyra e Planifikimit të Karrierës. Bazuar tek Procedura e Praktikës Profesionale, Zyra e Planifikimit të Karrierës ka detyrimin e shpërndarjes së formularëve të aplikimit të praktikës profesionale, mbikqyrjen e plotësimit të tyre, koordinimin e marrëdhënieve midis departamentit dhe institucioneve në të cilën studentët e kryejnë praktikën dhe mbledhjen e të gjithë dokumentacionit të detyrueshëm të kësaj procedure. (Evidencë nr. 27 Procedurë e ndjekjes së praktikës profesionale)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve janë struktura në varësi të Dekanatit të Studentëve të cilat pas mbikqyrjes, mbledhjes, shqyrtimit, përpunimit dhe analizës së të dhënave hartojnë raporte periodikë të cilat i vihen në dispozicion institucionit. Në këtë kuadër, GVJ shqyrtoi raportet e bashkangjitura si pjesë e dokumentacionit të DVV dhe konstatoi se raporti i zyrës së të diplomuarve ka bërë gjurmimin e të diplomuarve nga viti 2019 dhe në vazhdim për të dy ciklet e studimit të ofruara nga KU BËDER. Ky raport nuk përmban të dhëna për nivelin e punësimit të studentëve të programit të studimit Master në Mësuesi në Gjuhë Anglezë me profilet</p>

	<p>Mësues në AML dhe AMU sepse për shkak të ristrukturimit të bërë në vitin 2021 ky program nuk ka ende brezin e parë të të diplomuarve. Ndërsa raporti i zyrës së Planifikimit të Karrierës, vënë në dispozicion për GVJ, i referohet të dhënave për vitin akademik 2021- 2022 dhe paraqet listën e institucioneve partnere të KU BEDËR institucioneve ku studentët kanë kryer praktikën profesionale dhe aktivitetet e zhvilluara nga Zyra e Planifikimit të Karrierës. Sipas të dhënave të shprehura në raport (pika 4 Zhvillimi i Praktikave Profesionale në bazë të Departamenteve) për Departamentin e Edukimit dhe të Gjuhës Angleze 27 studentë të programit Master kanë kryer praktikën profesionale. Ky raport nuk përmban të dhëna specifike për programin Master në Mësuesi Gjuhë Angleze (aktualisht në proce akreditimi). Informacioni nuk është i përditësuar për vitin aktual të studimit, vit në të cilin studentët e këtij programi po zhvillojnë praktikën profesionale.</p>			
Konkluzione	<p><i>Njësia bazë bën publike të dhënat mbi përmbajtjen e programit të studimit. Faqja e internetit dhe Guida e Studentit përmbajnë informacione në lidhje me shërbimet që i ofrohen studentit, mjetet e komunikimit me institucionin, rregullat akademike, tarifat e studimit, shkëljet e rregulloreve etj. Të gjitha strukturat administrative vihen në funksion të informimit, krijimit dhe ruajtjes së kontakteve ne studentët. Këshilluesi Akademik siguron komunikimin me studentët dhe mbikqyrjen e procesit mësimor përgjatë gjithë ciklit të studimve. Zyra e Planifikimit të Karrierës luan njol mbështetës për studentët që kryejnë praktikën profesionale. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve hartojnë raporte periodikë të cilat i vihen në dispozicion institucionit. Raporti i zyrës së të diplomuarve ka bërë gjurmimin e të diplomuarve për 4 vitet e fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Në referencë me informacionin në RVB dhe dokumentacionin shoqërues në DVV, GVJ konstaton se KU “BEDËR” ka hartuar Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit dhe Politikat e Cilësisë për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, si dhe një formular vlerësimi të vazhdueshëm për mësimdhënien në nivel institucional, ku përfshihen komponentë si: syllabus-i, metodat e mësimdhënies, detyrat/ projektet e lëndës, metodat e vlerësimit të studentit, i cili plotësohet nga eprorët e pedagogut, me qëllim identifikimin dhe promovimin e pikave të forta, dhe dhënien e sugjerimeve në rast se del e nevojshme (Evidenca nr. 76 Udhëzuesi për Mësimdhënien Inovative; Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë; Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit në RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ konstaton se me Vendim të Senatit Akademik të KU “BEDËR”, janë ngritur dy struktura përgjegjëse të cilat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës - akademik në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe Gjuhës angleze: 1.Komisioni i përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS); 2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” (NJSBC). GVJ konstaton se këto struktura e mbështesin veprimtarinë e tyre në rregulloret përkatëse (Evidenca nr. 18 Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë; Evidenca nr. 28 Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e NJSBC; Evidenca nr. 31 Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies,</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur në DVV, se KU “BEDËR”, garanton përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të formave dhe metodave inovative të mësimdhënies duke i anëtarësuar ata në struktura që sigurojnë cilësinë dhe standartet në procesin mësimor në nivel isitucional</p>

<p>të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>(KPGSCIPS) dhe në nivel fakulteti (NJSBC). Këto struktura ofrojnë ekspertizë në zbatimin e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të mësimdhënies, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve. së studentëve vlerësimit (Evidenca nr. 96 Anketë vlerësimi të studentëve për programin e studimit; Evidenca nr. 46 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Caktimin e Këshilltarëve Akademikë; Evidenca nr. 47 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Përcaktimin e Përfaqësuesit të Karrierës dhe për Koordinimin me Zyrat e Tjera, Evidenca nr. 54 Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstaton se NJSBC dhe Departamenti i Edukimit dhe i Gjuhës angleze, bëjnë publike rezultatet e gjetjeve nga plotësimi i anketimeve të studentëve për vlerësimin e lëndës dhe personelin akademik. Rezultatet bëhen publike në raportet e pasqyruara në faqen zyrtare të institucionit: https://qac.beder.edu.al/files/RAPORTI-I-NJSBC-2021-2022-ANGLISHT-docx-2-1.pdf GVJ konstaton se është realizuar anketimi për vlerësimin e institucionit, viti akademik 2021-2022, lidhur me rubrikat: Infrastruktura dhe Shërbimet; Mbështetja dhe këshillimi akademik; Mbështetja nga dekanati i studentit. Rezultatet e anketimeve të studentëve, pedagogëve dhe stafit administrativ publikohen në formën e raporteve dhe relacioneve, të tilla si: Raport i anketës së vlerësimit të stafit akademik për institucionin 2021-2022; Relacion i anketës së stafit administrativ 2021-2022; Relacion i anketës së studentëve për institucionin 2021-2022 në faqen zyrtare të institucionit: https://qac.beder.edu.al/page/survey-reports.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstaton nga takimi në institucion se shembujt e praktikave më të mira që dalin si rezultat i vlerësimit të cilësisë, promovohen nga KU "BEDËR", duke shpallur listën me personelin akademik që gëzon performancën më të lartë akademike për secilin fakultet. <i>GVJ sugjeron që kjo praktikë të përfshihet edhe në rregulloret përkatëse të strukturave monitoruese dhe politike bërëse për grantimin e cilësisë si rregullorja e NJSBC-së dhe KPGSCIPS.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se KU "BEDËR" ka hartuar "Politikat për Përmirësimin e Programeve të Studimit" dhe "Politikat e Cilësisë" për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, si dhe një formular vlerësimi të vazhdueshëm për mësimdhënien në nivel institucional, ku</p>


	përfshihen komponentë të zhvillimit të metodave dhe monitorimit të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	KU “BEDËR” nëpërmjet strukturave përgjegjëse që ka ngritur si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore, ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, Neni 103, Statutin e institucionit, Neni 89/90 dhe Rregulloren e studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë, Neni 53 (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër” ; Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë ; Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit).
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ konstaton se Neni 6 i Rregullores për Funkcionimin dhe Organizimin e NJSBC-së parashikon se kjo strukturë përbëhet nga pesë (5) anëtarë, nga të cilët: një (1) kryetar, dy 2 përfaqësues personel akademik, një (1) nga Këshilli studentor dhe një (1) ekspert i jashtëm. (Evidenca nr. 28 Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizimin e NJSBC).
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe	GVJ konstaton se institucioni, me të cilin KU “Bedër” ka bashkëvepruar për procesin e vlerësimit të jashtëm, siç është parashikuar në Ligjin për Arsimin e Lartë nr.80/2015, është Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, proces nga i cili evidentohet se ky institucion ka kryer procedurën e akreditimit periodik institucional dhe me Vendim të BA, Nr. 57, dt. 16.12.2021 është i akredituar për pesë (5) vite (Evidencë- Procedura ASCAL-Vendim Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Kolegji Universitar Bedër).

<p>proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit Master Profesional për “Mësues, gjuhë angleze” në “AML”/“AMU” nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm deri më tani, pasi është në vitin e dytë të veprimtarisë pas lincensimit të tij. GVJ vlerëson se raportet e vlerësimeve të brendshëm dhe të jashtme për institucionin dhe programet e studimit janë bërë publike në faqen zyrtare të KU “BEDËR” https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se KU “Bedër” përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në rregullore specifike për monitorimin e cilësisë të tilla si: formular vetëvlerësimi për personelin akademik; anketat e studentëve për lëndën dhe pedagogun; vlerësimi i studentëve, personelit akademik dhe stafit administrativ për institucionin, formular për vlerësimin e vazhduar të mësimdhënies, (Evidenca nr. 30 Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve; Evidenca nr. 28 Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizmin e NJSBC; Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit; Evidenca nr. 75 Anketë Vlerësimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit; Evidenca nr. 96 Anketë vlerësimi të studenteve për programin e studimit).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KU “BEDËR” nëpërmjet strukturave përgjegjëse që ka ngritur si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore: 1.Komisioni i përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS); 2. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” (NJSBC) ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, Neni 103, Statutin e institucionit, Neni 89/90 dhe Rregulloren e studimeve dhe provimeve të Ciklit të dytë, Neni 53. KU “Bedër” përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në rregullore specifike për monitorimin e cilësisë si Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve; Rregullorja për Funkcionimin dhe Organizmin e KPGSCIPS dhe NJSBC-së.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Referuar informacionit në RVB dhe dokumentacionit shoqërues të tij, GVJ evidenton se KU “BEDËR” zbaton një procedurë të formalizuar e të dokumentuar, përsa i përket mekanizmave për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit. Në funksion të sigurimit të cilësisë, GVJ konstaton se institucioni ka hartuar dhe ka miratuar politika të cilësisë dhe përmirësimit të programeve të studimit (Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit; Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë). GVJ konstaton se KU “BEDËR” publikon dhe u bën të njohura autoriteteve përgjegjëse raportet dhe relacione përkatëse të procesit të vlerësimit të brendshëm, të cilat përfshijnë përparësitë, mangësitë dhe rekomandimet për vlerësimin tërësor në nivel institucioni dhe vlerësimin në nivel të programeve të studimit https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ evidenton se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë dhe me një plan masash. Konstatohet nga GVJ se me Urdhër të rektorit të KU “BEDËR” është hartuar një plan veprimi për plotësimin e rekomandimeve që kanë dalur nga procesi i fundit i vlerësimit të jashtëm në nivel institucional me Vendim BA nr 57, dt.16.12.2021 (Evidenca nr. 78 Plani i Masave për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për Institucionin). Gjithashtu njësia bazë, Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze kryen procesin e vlerësimit për personelin akademik dhe vlerësimin periodik të mësimdhënies (Evidenca nr. 71 Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 54 Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies</p>

	<p>Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton se mobiliteti i personelit akademik të programit të studimit Master profesional “Mësuesi, Gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU” si edhe angazhimi i vazhdueshëm i profesorëve të ftuar në këtë program studimi, ka garantuar një përvojë të larmishme në mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe është një metodë e drejtpërdrejtë në vlerësimin e mësimdhënies në kuadër mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. GVJ konstaton gjithashtu se institucioni kryen një procedurë korrekte në kuadër të vlerësimit të realizimit të programit të studimit, duke përfshirë forma vlerësimi në rregulloret e tij, si dhe në syllabuset e lëndëve në përputhje me udhëzimet ligjore për vlerësimin e detyrave të studentëve, të vëzhgimeve në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve dhe zhvillimit të praktikës profesionale në terren (Evidenca nr. 4 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, Neni 53; Evidenca nr. 19 Syllabus-et e Lëndëve të Programit).</p>
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” përdor një gamë të gjerë të metodave të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë të tilla si: Vlerësimi i programit të studimit për studentët e diplomuar; formular për vlerësimin e vazhduar të mësimdhënies; formular vetëvlerësimi për personelin akademik; anketat e studentëve për lëndën dhe pedagogun; formularë vlerësimi i studentëve dhe i personelit akademik dhe stafit administrativ për institucionin, (Evidenca nr. 75 Anketë Vlerësimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit; Evidenca nr. 54 Formulari i Vlerësimit të Vazhdueshëm të Mësimdhënies.pdf Evidenca nr. 96 Ankete vlerësimi te studenteve per programin e studimit; Evidenca nr. 33 Anketë Vlerësuese për Lëndën dhe Pedagogun nga Studentët; Evidenca nr. 31 Formulari i Vlerësimit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 32 Anketë Vlerësimi e Studentëve ndaj Institucionit; Evidenca nr. 30 Rregullorja e Anketave dhe Vlerësimeve).</p>

përfutuara nga ky program.				
Konkluzione	<p>KU "BEDËR" zbaton një procedurë të formalizuar e të dokumentuar, përsa i përket mekanizmave për shqyrtimin dhe mbikqyrjen periodike të programeve të studimit dhe garantimin për arritjen e objektivave formuese. GVJ konstaton se KU "BEDËR" nëpërmjet Komisionit të përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS) dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" (NJSBC), përdor një gamë të gjerë të metodave të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë të tilla si: Vlerësimi i programit të studimit për studentët e diplomuar; formular për vlerësimin e vazhduar të mësimdhënies; formular vetëvlerësimi për personelin akademik; anketat e studentëve për lëndën dhe pedagogun; formularë vlerësimi i studentëve dhe i personelit akademik dhe stafit administrativ për institucionin.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se Statuti i KU "BEDËR" (Neni 89/90) ka parashikuar dhe ka garantuar sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë nëpërmjet strukturave në nivel institucional, Komisioni i përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS) dhe në nivel fakulteti, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" (NJSBC) (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"). Në kuadër të gjithë përfshirjes së palëve të lidhura me cilësinë e programit të studimit, që KU "BEDËR" ofron, përfshirë edhe programin 'Master profesional', "Mësuesi, Gjuhë angleze" në "AML" dhe "AMU", në Statut është përcaktuar që përbërja e këtyre njësive të përfshijë disa përfaqësues, të tillë si: anëtarë të Senatit Akademik, personel akademik për secilin fakultet, përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe ekspertë të jashtëm (Evidenca nr.5 – Dokumentacion shtesë) Vendim Senati për ngritjen e Komisionit të Përhershëm per KPGSC dhe NJSBC-së

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” ka miratuar Rregulloren e funksionimit të KPGSCIPS, e cila parashikon funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat. Nenet 9/10/12 i kësaj rregulloreje parashikojnë mënyrën e shpërndarjes së informacionit mes njërive, detyrat përkatëse si dhe koordinimin e procesit të sigurimit të cilësisë (Evidenca nr. 18 Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVJ evidenton se NJSBC, si strukturë e cila garanton standartet e cilësisë në nivel fakulteti, drejtohet nga personel akademik i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës angleze, njëkohësisht lektore në programin e studimit ‘Master profesional’, “Mësuesi, Gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU”. Kjo njësi i drejton propozime strukturave, të tilla si njësi bazë ose Zyra e Burimeve Njerëzore për realizimin e trajnimeve të personelit akademik dhe leksioneve të hapura, me qëllim rritjen e performancës në mësimdhënie (Evidenca nr. 29 Shkresa nga NJSBC tek HR).</p> <p>GVJ evidenton se në DVV është paraqitur një (1) Formular i vlerësimin të vazhdueshëm në mësimdhënie në KU “BEDËR”, i cili përmban (7) fusha të vlerësimin (syllabus-i, metodat e vlerësimin të studentit, rezultatet e të nxënin, provimet, projektet/detyrat e kursit, metodat e mësimdhënies, si dhe një rubrikë për vlerësimin e përgjithshëm. Ky formular vlerësimi plotësohet nga eprorët e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit ‘Master profesional’, “Mësuesi, Gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU” (Evidenca nr. 54 Formulari i Vlerësimin të Vazhdueshëm të Mësimdhënies).</p> <p>GVJ vëren se Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës angleze ka hartuar një relacion i cili përmban rezultate për vetëvlerësimin e personelit akademik, por nuk përmban informacion, referuar grumbullimit të dhënave nga formulari i vlerësimin të vazhdueshëm në mësimdhënie në KU “BEDËR” (Evidenca nr. 71 Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik). GVJ konstaton se Zyra e të Diplomuarve ka aplikuar pyetësorin për gjurmimin e të punësuarve të diplomuar në programet e studimit deri në vitin 2020. Në këtë periudhë, programi i studimit ‘Master profesional’, “Mësuesi, Gjuhë angleze” në “AML” dhe “AMU” nuk ka ekzistuar, por ky raport</p>




	ka luajtur rol për çeljen e tij (Evidenca nr. 59 Raport i Zyrës së të Diplomuarve).
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se KU “BEDËR”, ka hartuar politikën e cilësisë, e cila parashikon gjithëpërfshirjen e personelit akademik, administrativ dhe studentor si aktorë të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, në respekt të Statutit të institucionit për anëtarësinë në komisione në nivel institucional (KPGSCIPS) dhe njësitë për garantimin e standarteve të cilësisë dhe programeve të studimit të fakulteteve, (NJSBC) (Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë; Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit; Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”). Gjithashtu, GVJ vlerëson se në mbrojtje kundër diskriminimit dhe pabarazisë së personelit ose studentëve, KU “BEDËR” ka hartuar politikat të posaçme (Evidenca nr. 80 Politika e KU “Bedër” për Barazi Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet).
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ konstaton se Statuti i KU “BEDËR”, Neni 89, ka parashikuar dhe ka garantuar sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë nëpërmjet përfshirjes së ekspertëve të jashtëm në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë institucionale dhe Programeve të Studimit (KPGSCIPS) dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” (NJSBC). Konkretisht këto dy struktura kanë nga një (1) ekspert të jashtëm në përbërje të tyre (Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”); Evidenca nr.5 Vendim Senati për ngritjen e Komisionit të Përhershëm për KPGSC dhe NJSBC-së).
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KU “BEDËR”, në kuadër të gjithëpërfshirjes së palëve të lidhura me cilësinë e programit të studimit, që ofron, përfshirë edhe programin ‘Master profesional’, ‘Mësuesi, Gjuhë angleze’ në “AML” dhe “AMU”, ka përcaktuar në Statut që në përbërje të njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë (KPGSCIPS) dhe (NJSBC) të përfshihen disa përfaqësues, si: anëtarë të Senatit Akademik, personel akademik për secilin fakultet, përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe ekspertë të jashtëm. Konkretisht këto dy struktura kanë nga një (1) ekspert të jashtëm në përbërje të tyre, një (1) student, përfaqësues nga Senati akademik dhe një (1) personel akademik për secilin fakultet. NJSBC drejtohet nga PA i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës angleze. Kjo njësi i drejton propozime Zyrës së Burimeve</i>

	<i>Njerëzore dhe për realizimin e trajnimeve të personelit akademik dhe leksioneve të hapura, me qëllim rritjen e performancës në mësimdhënie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se KU “BEDËR”, ka hartuar dokumentin e politikave të cilësisë për garantimin e cilësisë së brendshme dhe për përmirësimin e programeve të studimit, ku në pikën 7 parashikohet se rezultatet e vlerësimit janë të paanshme, paraqiten të përditësuara dhe i bëhen të njohura publikut. Po ashtu, neni 13 i rregullores së funksionimit të (KPGSCIPS) përcakton se publikimi rezultateve është i detyrueshëm (Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë; Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit; Evidenca nr. 18 Rregullorja për Funksionimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë).
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të brendshëm për institucionin dhe raportet e vlerësimit të jashtëm, në respekt të këtyre rregulloreve, publikohen në faqen elektronike zyrtare të institucionit: https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports GVJ konstaton se publikimi i informacionit të vlerësimit për programin e studimit realizohet në mbështetje të rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale (Evidenca nr. 82 Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ konstaton se KU “BEDËR” ka hartuar një plan masash në përmbushje të rekomandimeve të lëna nga procesi I akreditimit institucional (Evidenca nr. 78 Plani i Masave për Plotësimin e Rekomandimeve të BA për Institucionin). GVJ konstaton se raportet e vlerësimit të brendshëm, (vlerësimi për institucionin nga studentët, personeli akademik dhe administrativ) përmbajnë rekomandime dhe sugjerime për përmirësim. Megjithatë, GVJ nuk

	<p>evidenton raste të hartimit të plan veprimtarisë nga strukturat e posaçme si NJSBC, Departamenti i Edukimit dhe gjuhës angleze dhe Dekanati për përmbushjen e këtyre sugjerimeve dhe rekomandimeve, sidomos për vlerësimin e brendshëm lidhur me: vlerësimin e vazhdueshëm në mësimdhënie në KU “BEDËR”, programet e studimit, vlerësimin e personelit akademik nga studentët si dhe vetë-vlerësimin e tyre (Evidenca nr. 71 Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik; Evidenca nr. 36 Raporti Vjetor i Departamentit të Edukimit dhe Gjuhës Angleze, Viti Akademik 2021-2022).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se KU “BEDËR” është angazhuar nëpërmjet ngritjes së strukturave përgjegjëse për hartimin e politikave për sigurimin e standarteve të cilësisë për programet e studimit, të realizojë procese vetëvlerësimi gjithëpërfshirëse, mbështetur në rregullore të posaçme (Evidenca nr. 94 Politika e Cilësisë.pdf Evidenca nr. 95 Politika KU “Bedër” për Përmirësimin e Programeve të Studimit; Evidenca nr. 18 Rregullorja për Funksonimin dhe Organizimin e KP për Garantimin e Standardeve të Cilësisë). GVJ konstaton se NJSBC ka kryer procesin e vlerësimit të brendshëm të kategorizuar sipas të anketuarve, të cilët janë: studentë, personel akademik, dhe administrativ (Evidenca nr.6 Raportet e Vlerësimit nga NJSBC për anketat nga PA dhe studentët për vlerësimin e pedagogut lendes dhe shërbimeve në KUB).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Politikat e cilësisë së KU “BEDËR” dhe rregullorja e (KPGSCIPS) kanë parashikuar organizimin e mbledhjeve të komisionit, planifikimin dhe informimin e burimeve njerëzore që angazhohen në procesin e sigurimit të cilësisë, të cilët asistohen nga NJSBC dhe DEGJA në bashkëpunim me Këshillin Studentor. Rezultatet e takimeve për informimin mbi rëndësinë e procesit të vlerësimit dhe gjithë përfshirjes publikohen në faqen zyrtare elektronike të institucionit https://qac.beder.edu.al/activities. GVJ konstaton se DEGJA ka përfshirë studentët e diplomuar në procesin e vlerësimit për programet ekzistuese të studimit që ofronte departamenti deri në vitin 2020 (Evidenca nr. 59 Raport i Zyrës së të Diplomuarve).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme rregullatore të Institucionit, janë transparente dhe mundësojnë parimisht akses jo vetëm nga studentët, por dhe nga</i></p>

	<i>çdo i interesuar. Publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin e aplikueshëm dhe me aktet rregullatore të brendshme të Kolegjit. Institucioni ka parashikuar procedurat e nevojshme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: Mësuesi, Gjuhë Angleze me Profile: “ Mësues për Arsimin e Mesëm të Lartë” dhe “Mësues për Arsimin e Mesëm të Ulët”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi, gjuhë angleze” me profile: “Mësues për arsimin e mesëm të lartë” dhe “Mësues për arsimin e mesëm të ulët” ofrohet në gjuhën angleze, duke i mundësuar studentëve të cilët zgjedhin këtë program studimi që të marrin njohuri e të specializohen jo vetëm në fushën e edukimit, por edhe të ndjekin pa shkëputje pas ciklit Bachelor, procesin e mësimdhënies në gjuhën angleze;
2. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie, si dhe lektorë të ftuar në KU “Bedër” kanë realizuar orë të hapura, seminare ekstra kurrikulare dhe trajnime të specializuara në fushën e edukimit, të cilat kontribuojnë në rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe rritjen e kapaciteteve të stafit mësimdhënës;
3. Studentët e këtij program studimi, në përfundim të tij, vlerësohen përpos sistemit shqiptar të vlerësimit të shprehur notë dhe fjalë, edhe me sistemin e brendshëm të KU “Bedër” të shprehur me pikë, shkronjë dhe koeficientin e mesatares së ponderuar sipas përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit, formë e cila lehtëson njehsimin e procedurës së vlerësimit në raste të mobiliteteve ose ndërkombëtarizimit të studimeve;




4. KU "Bedër" nxit veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të këtij programi studimi duke ndihmuar në sigurimin e burimeve të financimit të dhëna nga vetë institucioni. Personelit akademik u është krijuar mundësia për të botuar punimet e tyre në revistën shkencore të institucionit "Bedër University Journal of Educational Sciences";
5. Institucioni KU "Bedër" është angazhuar maksimalisht në hartimin e politikave për garantimin e standarteve të cilësisë së programit të studimit dhe ka vënë në dispozicion një infrastrukturë të pasur me teknologji të përparuar digjitale për realizimin e veprimtarisë mësimore;
6. Institucioni ka vënë në dispozicion të këtij program studimi një sistem digjital funksional dhe efikas (BIS) me qëllim administrimin e procesit mësimor duke ofruar lehtësimin e procedurave të ruajtjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave dhe informacionit;
7. Stafi akademik mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme ecurinë akademike të studentëve dhe tregon një mbështetje të veçantë ndaj tyre përgjatë gjithë ciklit të studimeve;

b. Pika të dobëta:

1. Praktika profesionale, lëndë e kategorisë (D) të kuadrit të përgjithshëm të veprimtarive formuese në këtë program studimi, zë 10 % të krediteve totale dhe nuk është lënë hapësirë për lëndë të tjera plotësuese si gjuhë e huaj apo njohuri kompjuterike të kësaj katogorie sipas VKM 41/2018; **(Standardi III.4)**
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar në këtë program studimi nuk i përmbush plotësisht detyrimet dhe dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin 80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si kusht për të dhënë mësim në këtë program studimi, pasi në mësimdhënie janë angazhuar personel akademik me kualifikimin 'Master i Shkencave'; **(Standardi III 1, Kriteri 4; Standardi IV 1, Kriteri 1)**
3. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës së rekomanduar në syllabuset e lëndëve nuk është përditësuar me botimet e fundit të viteve të fundit. Gjithashtu edhe burimet e sygjera për shfrytëzim nga bibliotekat online nuk janë të përcaktuara; **(Standardi IV.3-Kriteri 2)**

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që institucioni duhet të zhvillojë mekanizmat e duhur për sigurimin e pjesëmarrjes si palë partnere në projekte ndërkombëtare me fokus programin e studimit Master Profesional në "Mësuesi, gjuhë angleze" me profile: "Mësues për arsimin e mesëm të lartë" dhe

- “Mësues për arsimin e mesëm të ulët”, si edhe të rrisë numrin e mobiliteteve të personelit akademik dhe studentëve në programet ndërkombëtare të studimit;
2. Rregulloret e brendshme të institucionit duhet të përcaktojnë modalitetet për të përcaktuar kufinj të midis vlerësimit të vazhduar përgjatë vitit akademik dhe vlerësimit final të lëndëve;
 3. GVJ rekomandon që të unifikohet plani mësimor në rregulloren e programit të studimit “Master Profesional” dhe në çdo rregullore tjetër të KU “Bedër” sipas kuadrit të përgjithshëm të veprimtarive formuese të programit të studimit të miratuar nga MAS;
 4. GVJ rekomandon që në kategorinë e lëndëve plotësuese (D) të futen edhe lëndë lëndë të tjera plotësuese si gjuhë e huaj apo njohuri kompjuterike sipas VKM 41/2018;
 5. Ekspertët e GVJ rekomandojnë që rubrika e literaturës së rekomanduar në programet lëndore duhet të përditësohet me botimet e viteve të fundit sipas tipologjisë së lëndës. GVJ gjithashtu sygjeron që të merret parasysh edhe mundësia që të përcaktohen edhe burimet online të ofruara nga bibliotekat digjitale;
 6. GVJ rekomandon se institucioni duhet të marrë masa dhe të shfrytëzojë të gjitha burimet dhe mundësitë për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi;
 7. GVJ rekomandon se angazhimi i pedagogëve efektivë në këtë program studimi duhet të kryhet në përputhje të plotë me parashikimet dhe dispozitat ligjore për titujt dhe gradat shkencore të personelit akademik që jep mësim në këtë cikël studimi;

Conclusions of the Evaluation of the second cycle Professional Master study program in: "Teacher of English Language" with profiles: "Teacher for Upper Secondary Education" and "Teacher for Lower Secondary Education"


a. Strengths and affirmations:

1. The Professional Master study program in "Teacher of English language" with profiles: "Teacher for upper secondary education" and "Teacher for lower secondary education" is offered in English language, enabling students who choose this study program to obtain knowledge and specialize not only in the field of education, but also to attend this study program in English language without interruption following the Bachelor cycle;
2. The academic staff engaged in lecturing, as well as visiting professors at KU "Bedër" have held open classes, extra-curricular seminars and specialized training in the field of education, which contribute to the increase of creative and implementation skills in students and the growth of the capacities of the teaching staff;

3. At the end this study program, the students attending it are evaluated in addition to the Albanian evaluation system expressed in grades and words, also with the internal system of KU "Bedër" expressed in points, letters and the coefficient of the average score according to the definitions in the regulation of the study program, a form which facilitates the calculation of the evaluation procedure in cases of student mobility or internationalization of studies;
4. KU "Bedër" institution is maximally engaged in the drafting of policies to guarantee the quality standards of the study program and provides an adequate infrastructure enhanced by advanced digital technology in the implementation of the Professional Master Study program in "English Language Teaching";
5. The academic staff scientific and research activity and progress are financially supported by the institution. The academic staff has been given the opportunity to publish their scientific works in the institutional scientific journal "Bedër University Journal of Educational Sciences";
6. The provision of a full and efficient operation digital system (BIS) for the management of the teaching process and secretariat activity, providing the facilitation of the procedures of storage, administration and distribution of data and information;
7. Staff members' sustainable assistance on students' academic progress and a constant overview and attendance of their academic achievements;

b. Weaknesses:

1. The professional practice course in this study program occupies 10% of the total credits in the category of supplementary subjects (D) and has not left space for other supplementary courses such as foreign language or computer knowledge in compliance with Decision 41/2018; *(Standard III.4)*
2. The effective academic staff engaged in the study program does not completely fulfill the obligations and the legal provision in Law No. 80/2015 on "Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania" on scientific titles and degrees, as a condition for lecturing in this cycle of study, due to the fact that academic staff qualified with the degree 'Master of sciences' is engaged in lecturing in this study program; *(Standard IV 1, Criterion 1)*
3. A significant part of the required literature in the course syllabi of the Professional Master Study program in "English Language Teaching" is not updated with recent publications of the last decade. The online library resources provided are not recommended as well; *(Standard IV.3-Criterion 2)*

Recommendations

1. External Evaluation Group (EAG) recommends that the institution should develop appropriate mechanisms for ensuring participation as a partner in international projects with a focus on the Professional Master's study program in "Teacher of English language" with profiles: "Teacher for higher secondary education" and "Teacher for lower secondary education, as well as to increase the number of mobility of academic staff and students in international study programs;
2. The internal regulations of the institution must determine the modalities to determine the margins between continuous evaluation throughout the academic year and the final evaluation of the courses;
3. EAG recommends that the curriculum be unified in the Regulation of the "Professional Master" study program and in any other regulation of KU "Bedër" according to the general formative framework of the study program approved by MAS;
4. EAG recommends that other supplementary courses such as foreign languages or computer knowledge be included in the category of complementary subjects (D) according to VKM 41/2018;
5. EAG experts recommend that the study program syllabi literature section should be updated with the publications of the last years according to the typology of the subject. The possibility of recommending electronic sources of literature such as online libraries offered by the institution should also be taken into account;
6. The institution should take adequate efficient measures and exploit relevant possibilities to increase the number the students enrolled in this study program;
7. EAG experts recommend that the engagement of the academic staff teaching in this study program should be carried out in full accordance with the legal provisions on scientific titles and degrees;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

